



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 13 SHKURT 2020**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 13. FEBRUARA 2020. GODINE**

**SHKURT - FEBRUAR
2020**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare.

Dnevni red

1. Razmatranje predlog-odlukes o formiranjū parlamentarnih komisija.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Po e fillojmë këtë seancë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2020.

Konstatoj që në sallë janë të pranishëm 97 deputetë, që do të thotë se kemi kuorum të mjaftueshëm dhe janë plotësuar kushtet për punë.

Në fillim, në nderim të Nexhmije Pagarushës, bilbilit të këngës shqipe, sot do t'ia fillojmë seancës me zërin e saj dhe me njërin nga perlat më të bukura të muzikës shqipe.

Regjia, ju lus!

(Interpretohet kënga “Baresha” nga Nexhmije Pagarusha)

(Duartrokitje)

KRYETARJA: I përhershëm qoftë kujtimi për Nexhmije Pagarushën! Këngët dhe vepra e saj do të mbeten të pavdekshme. Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se me kërkesën time si kryetare e Kuvendit, presidenti i Republikës ka ndërmarrë veprimet ligjore, duke kërkuar nga KQZ-ja që të bëhet zëvendësimi i deputetëve pas emërimit të ministrave në Qeverinë e Kosovës dhe pas dorëheqjes së një deputeti.

Megjithatë, pas përgjigjes së KQZ-së akoma nuk kemi dekret të presidentit të Republikës për këta 12 deputetë, në qoftë se ka gjatë ditës dhe na vjen ajo letër, do të kërkojmë nga deputetët ta bëjnë betimin, megjithatë për momentin kjo nuk mund të bëhet në mungesë të këtij dekreti. Shpresojmë që në përputhje me ligjet në fuqi procedurat të përfundojnë sa më shpejt që të jetë e mundur.

Vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

E ka kërkuar fjalën deputeti Rexhep Selimi, kryetar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Urdhëroni, zoti Selimi e ka fjalën!

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kërkoj një mocion procedural për shqyrtimin e projekt-vendimit të Qeverisë me numër 04/02, datë 12. 2. 2020 për zgjatjen buxhetore për muajin mars të vitit 2020.

E dimë që për miratimin e këtij propozim-vendimi kërkohet votimi për shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 15, paragrafi 7 dhe neni 56 të Rregullores së Punës së Kuvendit. Pra, kërkoj që kjo të futet në rend të ditës të kësaj seance. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Selimi!

Në sallë janë 103 deputetë, ndërkohë i dëshirojmë mirëseardhje kryeministrit të vendit.

Kërkesa e deputetit Rexhep Selimi që të shqyrtohet propozim-vendimi për zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për muajin mars 2020. Ju njoftoj që për miratim të këtij vendimi kërkohet votimi për shmangie nga afatet procedurale, të parapara në nenin 15, paragrafin 7 dhe nenin 56 të Rregullores së Kuvendit. Për shqyrtimin e këtij propozim-vendimi kërkohet deklarimi me votim për shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

Fjalën, në qoftë se dëshirojnë shefat e grupeve parlamentare.

Pas Grupit Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje, fjalën e ka Grupi Parlamentar i LDK-së dhe pastaj vazhdojmë sipas radhës. Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrah propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për vazhdimin buxhetor edhe për një muaj.

Ndësa sa i përket situatës së krijuar prapa jush aty, po më pëlqen instalacioni artistik i Partisë Demokratike të Kosovës, ju juroj sukses! Faleminderit!

KRYETARJA: Vetëm kërkoj nga regjia që mikrofonat e deputetëve të rregullohen, sepse ne që jemi këtu nuk po ju dëgjojmë mirë. Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, bazuar në rëndësinë e vendimit për të cilën po diskutojmë, sepse në mungesë të këtij vendimi, sigurisht që edhe të punësuar që realizojnë paga

nëpërmjet Buxhetit të Republikës së Kosovës do të mbesin pa paga, edhe pensionistët nuk mund t'i marrin pensionet e tyre dhe do të ketë edhe vështirësi të tjera, edhe pse vonesat në krijimin e institucioneve totalisht të paarsyeshme kanë krijuar dëme në vend, Partia Demokratike e Kosovës, bazuar në rëndësinë e vendimit do ta mbështesë dhe do të votojë për. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit shumë për korrektësinë! Vazhdojmë me Grupin Parlamentar të AAK-së, zoti Daut Haradinaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare

Kryeministër,

Ministra,

Të nderuar deputetë,

Të mos i përsëritim fjalën, dihet pesha dhe rëndësia e këtij votimi. Ne nuk jemi dakord me buxhetin, siç e kanë paralajmëruar, por gjithsesi do ta japim votën pro vazhdimit për një muaj të projektbuxhetit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit edhe nga ju për korrektësinë.

Fjalën e ka zoti Haxhi Shala, Grupi Parlamentar Nisma-AKR.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetare!

Përsëritje Kabinet qeveritar,

Deputetë,

Qytetarë,

Edhe Grupi Nisma-AKR do ta mbështesë vazhdimin e buxhetit për një muaj, siç ka ardhur propozimi nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Fjalën e ka Grupi Parlamentar Lista serbe, në qoftë se është këtu dikush, sepse nuk po shoh që janë lajmëruar, shefi i grupit, zoti Simiq.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsednice!

Zbog značaja, Srpska lista će podržati glasanje danas.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Simiq! Tani fjalën e ka Albert Kinolli nga Grupi 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh nevojën emergjente dhe arsyet që i folëm më herët, edhe ne si Grup Parlamentar 6+ e përkrahim këtë mocion. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Kinolli!

Votimi i parë është për ta përfshirë këtë pikë në rend të ditës, kërkoj nga zoti Selimi në radhë të parë ta sqaroj në qoftë se propozimi juaj është që të futet si pikë e parë e rendit të ditës apo si pikë e dytë, pas konstituimit të komisioneve dhe pastaj do të procedojmë me votim. Zoti Selimi e ka fjalën!

REXHEP SELIMI: Po, zonja kryetare, kërkoj që të futet si pikë e parë e rendit të ditës.

KRYETARJA: Faleminderit! Dhe, ju falënderoj po ashtu që e potencuat urgjencën e kësaj çështjeje, pas këtij propozimi që kjo të futet si pikë e parë e rendit të ditës, ju njoftoj që për t'iu shmangur Rregullores, Kuvendi vendos me 2/3 e deputetëve të pranishëm në seancë, në përputhje me nenin 84 të kësaj Rregulloreje. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim, në sallë janë 103 deputetë.

Konstatoj paraprakisht që ka disa deputetë që akoma nuk i kanë kartelat gati dhe, pasi të numërohen votat e atyre që kanë kartela, do të kërkoj edhe nga deputetët e tjerë që me ngritje dore të votojnë, por ta sqaroj edhe një herë, deputetët për të cilët akoma nuk e kemi dekretin dhe nuk e kanë dhënë betimin, nuk mund të marrin pjesë në votim. Atëherë, ata paskan dalë nga salla, faleminderit.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim!

Votojmë tash! Faleminderit!

Kanë votuar 92 deputetë. 92 vota për. Asnjë votë kundër, asnjë abstenim.

Kërkoj falje, pra ka edhe deputetë që do të votojnë pa kartela. Të gjithë jeni për? Po supozoj. Edhe 7 vota, do të thotë 92 vota me pajisje elektronike dhe 7 vota me dorë, total 99 vota për këtë propozim, për: Shqyrtimin e vendimit për zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për muajin mars 2020.

Pra, kjo pikë futet si pikë e parë e rendit të ditës. Në bazë të këtij vendimi për plotësimin e rendit të ditës, vazhdojmë me shqyrtimin e pikës:

1. Shqyrtim i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars të vitit 2020, të përcaktuar me Ligjin nr. 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019

E ftoj ministrin e Financave, zotin Besnik Bislimi, që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-vendimin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI BESNIK BISLIMI: Faleminderit, zonja kryetare!

E nderuar zonja kryetare e Kuvendit të Kosovës, zonja Osmani!

E nderuar nënkryetare, zonja Arbërie Nagavci,

I nderuar kryeministër, zoti Kurti,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Në këtë mbledhje të Kuvendit paraqes para jush kërkesën dhe rekomandimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për muajin mars të vitit 2020, në mënyrë që të sigurojmë vazhdimësinë e kryerjes së obligimeve deri në miratimin e Ligjit të buxhetit për këtë vit, bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, neni 24, paragrafi 2.

Ministria e Financave, në pajtim me përcaktimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, përkatësisht neni 24, pasi është plotësuar kushti ligjor dhe paragrafi 1a, ka bërë zgjatjen e ndarjeve buxhetore për dy muaj të parë të vitit 2020, edhe atë në tërësi për 1/6 e alokimeve vjetore të vitit paraprak. Mirëpo, tani kjo shumë ka mjaftuar vetëm për mbulimin e shpenzimeve deri më datën 28 shkurt. Nga vlerësimet tona preliminare, por edhe ecuritë e ekzekutimit të buxhetit për muajin janar, lidhur me shpenzimet e buxhetit për vitin 2020 konstatojmë se zgjatja e ndarjeve buxhetore për 1/6 e buxhetit të vitit 2019 nuk ka qenë dhe nuk do të jetë e mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve ligjore për kategoritë e subvencioneve, përkatësisht skemave sociale dhe pensione, atyre bazike, kontributdhënëse, për invalidët e luftës dhe veteranët. Apo edhe për pagat për disa organizata, meqë rast sipas autorizimeve të ligjit, për të mundësuar procesimin e skemave të muajit shkurt do na duhen edhe alokimet e parakohshme të buxhetit nga buxheti i muajit mars.

Vendimi juaj, të nderuar deputetë, për zgjatjen e ndarjeve buxhetore edhe për një muaj, do të vlejë deri me rastin e aprovimit të hyrjes në fuqi të buxhetit për vitin 2020 dhe për shpenzimet e ndodhura për periudhën e zgjatjeve të ndarjeve që do të realizohen në harmonizimet e nevojshme. Edhe një herë ju falënderoj për mbështetjen e përgjithshme që dhatë për futjen me mocion të kësaj pike në rend të ditës dhe ju lus që të votoni në favor. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Ftoj shefat e grupeve parlamentare që të deklarohen lidhur me propozimin e Qeverisë. Zoti Selimi e ka fjalën, nga Lëvizja Vetëvendosje!

REXHEP SELIMI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet Propozim-vendimin e Qeverisë për zgjatjen buxhetore për muajin mars të vitit 2020, njëkohësisht kërkojmë nga të gjithë deputetët e Kuvendit që ta mbështesin këtë dhe ta votojnë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Gashi, nga Lidhja Demokratike e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e mbështet propozimin e Qeverisë për zgjatjen buxhetore. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Hamza, nga PDK, nuk ka nevojë, nuk e dëshiron fjalën. Zoti Haradinaj, nga AAK në qoftë se e dëshiron fjalën? Nuk e dëshiron fjalën.

Zoti Shala nga Nisma? Jo! Zoti Simiq nga pakicat? Nuk e ka kërkuar fjalën. Zoti Kinolli nga 6+, nuk e ka kërkuar fjalën.

Atëherë, meqenëse kanë përfunduar shifat e grupeve parlamentare, fjalën e kanë deputetët sipas radhës. Zoti Ferat Shala nga PDK e ka fjalën. Urdhëroni, zoti Shala!

E tërhoqi fjalën edhe zoti Shala, atëherë meqenëse nuk ka kërkuar fjalën dikush tjetër nga deputetët, e vendos propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen buxhetore në votim.

Regjia dhe deputetët përgatituni për votim, votojmë tash! A ka deputetë që votojnë me dorë?

Atëherë, 92 deputetë kanë marrë pjesë në votim elektronik dhe 8 deputetë kanë votuar me dorë. Do të thotë, total 100 deputetë kanë votuar për, asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Kalon Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për zgjatjen e ndarjeve buxhetore për muajin mars. Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

2. Shqyrtim i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se Kryesia e Kuvendit, në mbështetje të nenit 15, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit dhe në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare që ishin prezentë në mbledhjen e mbajtur më 10 shkurt 2020 ka vendosur që seancës plenare t'ia procedojë Propozim vendimin për formimin e 14 komisioneve parlamentare.

Grupet parlamentare, në bazë të përfundimit të Kryesisë së Kuvendit i kanë propozuar emrat për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të komisioneve parlamentare, me përjashtim të Grupit Parlamentar të AAK-së, prandaj edhe e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së, zotin Haradinaj, që t'i propozojë deputetët për kryetarë, zëvendëskryetarë dhe anëtarë të komisioneve parlamentare sipas ndarjes për të cilën jemi dakorduar dhe votuar në mbledhjen e fundit të Kryesisë. Zoti Haradinaj, në qoftë se është këtu, e ka fjalën, t'i plotësojë emrat dhe pastaj do ta keni fjalën edhe ju.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Në parim edhe atë ditë unë kam shprehur shqetësimin pse duhet të ndahen komisionet përderisa nuk janë të gjithë përfaqësuesit e partive politike prezentë, por ajo çka ka rënë në sy pas atij takimi është se ne kemi ndërhyrë në Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, e cila kërkon plotësim-ndryshim me 2/3 dhe ajo nuk ka ndodhur në të njëjtën kohë. Po ashtu në një draft propozim të marrë nga ana juaj nuk e di se si e keni trajtuar Listën serbe, si pozitë apo opozitë, 6+ si pozitë apo si opozitë.

Ndarja proporcionale e deputetëve në komisione nuk është as për së afërmi e saktë me numrin e deputetëve shumicë në opozitë, në këtë rast me PDK-në, AAK-në, Nismën. Në rast se vetëm një minutë e shpenzoni kohë dhe e shihni brendapërbrenda atyre propozimeve, të cilat i kemi marrë, unë nuk shoh që është e balancuar në mes të numrit të deputetëve të shumicës. Tash, derisa ne nuk i kemi të qarta këto, ne do të kërkojmë kohë të na shpjegoni: e para, a ka ndërhyrje në Rregullore të Kuvendit, sepse i keni hequr dy komisione, i keni riemërtuar, është ndërruar ekzekutivi. E dyta, a është në proporcion me numrin e shumicës shqiptare në Kuvendin e Kosovës ndarja e barabartë në komisione dhe me numër të shumicës pozitë-opozitë. Dhe, e treta, si e cilësoni ju Listën serbe, pozitë a opozitë? Sepse, këtu nuk është e qartë.

Po ashtu 6+, është pozitë apo opozitë. Brenda 6+ deputetë të tjerë të komuniteteve janë të pozitës apo opozitës, sepse ka komisione, të cilat janë jo të formës së rregullt, por siç është, për shembull, AKI-ja, në këtë rast në traditën e kaluar është udhëhequr prej opozitës, ndërsa shumica brendapërbrenda komisionit është e kundërta. E bëra vetëm një krahasim të thjeshtë për një komision të caktuar dhe del se 8 me 4 është numri i deputetëve, kjo bëhet fjalë për Buxhetin për Transfere, kur dihet që, për shembull, kryetari i komisionit e ka të drejtën e dy votave, do të thotë është 7+1 votë shtesë është 8 me 4.

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Haradinaj! Në radhë të parë, siç e kam sqaruar në mbledhjen e fundit të Kryesisë, meqenëse numri i komisioneve zvogëlohet nga 16 në 14, kjo nënkupton që duhet të ndryshohet Rregullorja e Kuvendit. Ajo në çdo mandat është ndryshuar, sa i përket numrit të komisioneve, përfshirë dy mandatet e kaluara.

Rrjedhimisht, do të kërkohet votim me 2/3 për ta zvogëluar numrin nga 16 në 14, por ajo mund të bëhet vetëm me votim në seancën e Kuvendit, pra nuk bëhet nga ana e Kryesisë. Kryesia thjesht ka propozuar që kjo seancë të votojë zvogëlimin e numrit nga 16 në 14, siç jemi dakorduar që të gjithë që ishim prezentë në mbledhjen e Kryesisë.

Sa i përket proporcionit, siç e dini Kushtetuta kërkon që Komisioni për Kthim dhe Komunitete të udhëhiqet nga komunitetet pakicë dhe, po ashtu, sipas formulës për të cilën jemi dakorduar, edhe një komision tjetër u takon komuniteteve joshumicë. Rrjedhimisht, mbasin edhe 12 komisione të tjera, të cilat sipas formulës së dakorduar, e cila është formulë e përdorur tradicionalisht që disa mandate, janë ndarë, ku Lëvizja Vetëvendosje i merr 3 komisione, Lidhja Demokratike 3, PDK-ja 3, AAK-ja 2 dhe Nisma 1, në qoftë se nuk gabohem. Sa i përket asaj se kush është pushtet kush është opozitë, besoj që votimi i Qeverisë së Kosovës e ka sqaruar këtë çështje, por kjo nuk lidhet me komisionet parlamentare, sepse pavarësisht a janë pakicat pushtet apo opozitë, komisionet e caktuara udhëhiqen nga komunitetet joshumicë, sipas Kushtetutës.

Tjetra, zakonisht siç e dini, edhe në të kaluarën numri i deputetëve të koalicionit qeverisës në komisione është më i madh, por kryetari i komisionit nuk i ka dy vota, e ka një votë dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e AKI-së dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka kërkesa ligjore që ato të udhëhiqen nga opozita, rrjedhimisht edhe i takojnë opozitës. Po e sqaroj edhe një herë, i takon këtij Kuvendi të vendosë në qoftë se dëshirojmë ta ulim numrin e komisioneve nga 16 në 14, edhe në mandatin e kaluar, që kanë qenë 21 ministri, ne i kemi pasur vetëm 14 komisione, nuk ka asnjë arsye që tani t'i mbajmë 16, as për shkak të kostos financiare, as për shkak të problemeve organizative, sepse shumë më mirë 14 komisione mund ta mbikëqyrin punën e 15 ministrive dhe për këtë ne kemi pasur dakordim në mbledhjen e fundit të Kryesisë, megjithatë në mbledhjen e fundit të Kryesisë. Megjithatë, në qoftë se ka nevojë për sqarime shtesë, ne edhe mund të kërkojmë pauzë, ose një konsultim me shefat e grupeve parlamentare. Por, fillimisht, unë kërkoj që të deklarohen shefat e grupeve lidhur me këtë temë, para se ta vendos në votim. Zoti Selimi e ka fjalën dhe pastaj vazhdojmë me zotin Gashi.

REXHEP SELIMI: Po, zonja kryetare!

Ne e mbështetim propozim-vendimin për formimin e 14 komisioneve parlamentare. Njëkohësisht, kërkojmë që në momentin e procedimit për votim të tërhiqen emrat e deputetëve të cilët ne i kemi propozuar dhe që akoma nuk janë betuar si deputetë.

Theksoj edhe një herë, siç edhe dihet, presidenti i Kosovës nuk e ka kryer obligimin e tij kushtetues për dekretimin e deputetëve të rinj, të cilët i zëvendësojnë ata deputetë që kanë marrë pozicione në Qeverinë e Kosovës. Sidoqoftë, ne do ta mbështetim edhe ndryshimin e Rregullores, edhe propozim-vendimin e Kryesisë së Kuvendit për formimin e 14 komisioneve parlamentare. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar zonjë kryetare!

Sa i përket numrit të komisioneve në praktikën e kaluar, por edhe në praktikat para saj, seanca e Kuvendit në ditën e konstituimit, të miratimit të komisioneve, e aprovon numrin dhe fushëveprimtarinë e komisioneve. Ky aprovim bëhet me 2/3-at e të gjithë deputetëve, sepse është ndërhyrje në Rregulloren e Kuvendit. Ju e dini që Rregullorja aprovohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Pra, kjo nuk ka dilemë.

Ideja e 14 komisioneve ka ardhur si arsye e krijimit të një mbikëqyrjeje më të mirë parlamentare për Qeverinë dhe, po ashtu, të mos kemi komisione të panevojshme, pra të mos i kemi gjashtëmbëdhjetë a shtatëmbëdhjetë dhe kemi mbërri te ky konkluzion për reduktim.

Ka një çështje që duhet diskutuar, e që ka të bëjë me emrat e komisioneve. Ndoshta, dikush prej deputetëve do të flasë më vonë për të parë se çështja e administratës publike ndoshta nuk është e mbuluar mirë, ose nuk është e përmendur në mënyrë eksplicite. Dhe, sa i përket shqetësimit të zotit Haradinaj lidhur me numrin e anëtarëve nëpër komisione, ju e dini që për numrin e anëtarëve në komisione dhe për udhëheqjen e komisioneve përdoret një formulë dhe formula parasheh dhe ideja prapa saj është që të kemi... përfaqësimi në komisione bëhet mbi bazën e forcës politike aktuale në Kuvend. Pra, komisionet reflektojnë gjendjen politike në Kuvend. Përfundim bën Komisioni për Komisione dhe Kthim.

Të gjitha komisionet tjera e reflektojnë fuqinë politike të Kuvendit, që nënkupton në bazë të formulës, aq deputetë sa ka LDK-ja i takojnë proporcionalisht nëpër komisione. Tash po ta shikojmë kështu e ta detajojmë, i bie që ndoshta ne jemi pak më të diskriminuar, sepse i kemi 28 deputetë, ndërkohë që në çdo komision i kemi nga 2 anëtarë të komisionit. Vetëvendosja i ka 29 i ka nga 3 anëtarë, pra është çështje e organizimit, formula kështu e ka nxjerrë, për një deputet s'na nxjerr t'i kemi tre. Në rregull është. Është çështje formulash dhe është çështje e ndarjes së përgjegjësi.

Sa i përket kryesimit të komisioneve, kryetarët e komisioneve kanë votë të barabartë me anëtarët e komisioneve dhe mendoj se nuk kemi çështje tjera të paqarta, përveç faktit që administrata e paska renditur që deputetët të cilët nuk e kanë bërë betimin, nga radhët e LDK-së i paska renditur te anëtarët e komisioneve, megjithëse unë në njoftimin që e kam dërguar i kam njoftuar që nuk mund të vijmë në sallë dhe nuk mund të renditen për shkak se nuk e kanë bërë akoma betimin. Kemi shpresuar që betimi ndodh sot, por nuk ka ardhur dekreti i presidentit dhe presim në seancën e radhës, ose kur do të ndodhë kjo. Pra, me të gjitha këto rrethana, mendoj se ne jemi të gatshëm të procedojmë, por nëse opozita ka nevojë për sqarime shtesë ne jemi të gatshëm, po ashtu, të takohemi dhe t'i heqim këto dyshime, cilado qofshin ato. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Gashi! Fjalën e ka zoti Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Nëse duam ta lëshojmë këtë çështje në atë se a janë 14 komisione, 16 apo 12, ne si Parti Demokratike nuk e kemi problem po të jenë edhe 12 edhe nëse duam të thirremi veç te kostoja. Megjithatë, para se të kaloj në këto çështje pak populliste, dëshiroj t'i them disa çështje procedurale edhe për seancën e sotme, edhe për këtë temë që po e diskutojmë.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe në pajtim me nenin 47 të Rregullores së Kuvendit në pika të shkurtra do t'i paraqes disa aspekte procedurale të kësaj mbledhjeje plenare, e të cilat normalisht do të duhej të shtroheshin së bashku me çështjet e ndryshme, në kuadër të kohës së paraparë për deklarime jashtë kohës së paraparë për deklarime jashtë rendit të ditës, e që, fatkeqësisht, mua më duhet të bëj këtë deklarim jashtë rendit të ditës pikërisht për mungesë të rendit të ditës së kësaj seance, pra pa pikën e parë dhe të...

KRYETARJA: Zoti Hamza, kërkoj falje, më duhet të ju ndërpres. Kryesia nuk ka vendosur që të ketë deklarime jashtë rendit të ditës. Rrjedhimisht, duhet t'i përmbaheni rendit të ditës. Kryesia ka vendosur që të shkojmë vetëm me këtë rend të ditës, prandaj edhe ju lus që të deklaroheni lidhur me komisionet parlamentare.

BEDRI HAMZA: Unë po flas, zonja kryetare...!

KRYETARJA: Kryesia ka vendosur unanimisht për këtë rend të ditës.

BEDRI HAMZA: Zonja kryetare,

Unë po flas dhe po e citoj Rregulloren, së cilës ju, edhe unë, edhe secili në këtë sallë jemi të obliguar t'i përmbahemi. Prandaj, të lutem mos më ndërprit derisa ta përfundoj fjalën. Do t'i përmbahem kohës sime si shef i grupit parlamentar.

Kohën për deklarime jashtë rendit të ditës, e cila pikë është detyrim të përcaktohet nga kryetarja e Kuvendit, për sa është detyrim pikërisht nga kjo Rregullore, respektivisht neni 47 i saj, që ia garanton secilit deputet apo grup parlamentar që të deklarohej apo të diskutojë çfarëdo çështjeje të rendit të ditës brenda kohës së paraparë.

Nuk e di a është bërë me qëllim, mirëpo ua tërheqim vërejtjen se nëse keni menduar që ta shpërfillni së zbatuari Rregulloren e Kuvendit dhe gjithashtu ta shkëlpi një standard pothuajse 20-vjeçar në të gjitha legjislaturat, që në mbledhje plenare deputetëve apo grupeve parlamentare t'ua mohoni të drejtën e deklarimit jashtë rendit të ditës, jo vetëm se bëni shkelje flagrante të Rregullores, mirëpo duke tentuar që t'u përcaktoni e t'i dirigjoni të zgjedhurit e popullit se çfarë

të flasin, pavarësisht çështjeve të shumta e të ndryshme të interesit publik që mund të shtrojnë ata, është ndërhyrje në vetë mandatin e lirë të deputetit, të garantuar dhe të përcaktuar me Kushtetutë dhe aktet ligjore në fuqi.

Shpresoj që kur nuk e keni paraparë kohën për deklarime jashtë rendit të ditës nuk e keni menduar që të provohet, madje edhe të cenohet edhe vetë mandati i lirë i deputetit si përfaqësues i zgjedhur i popullit, që ju zonja kryetare në këtë rast veç e bëtë.

Ne si grup parlamentare më shumë dëshirojmë ta shohim si gabim teknik, i cili duhet përmirësuar e të mos përsëritet, se sa si qëllim që të cungohet fjala e lirë, e për rrjedhojë edhe të cenohet mbrojtja e interesit të qytetarëve dhe vetë mandatin, për të cilin jemi zgjedhur. Prandaj, lidhur me këtë çështje, meqenëse rendi i ditës i mbledhjes së sotme parasheh vetëm një pikë të vetme, pra votimin e strukturës së komisioneve parlamentare, udhëheqësit, por edhe anëtarët e tyre, propozojmë që në secilën mbledhje plenare të ardhshme të përcaktohet koha për deklarime jashtë rendit të ditës si pikë e parë dhe e veçantë e rendit të ditës së mbledhjeve të Kuvendit.

Një çështje tjetër që dua ta shtroj është fakti se, meqë janë propozuar 14 komisione parlamentare, prej të cilave katër komisione të përhershme dhe dhjetë komisione funksionale, siç e dini kjo pashmangshëm e implikon edhe domosdoshmërinë e ndryshimit të Rregullores, siç parashihet në nenin 81, sipas të cilit Rregullorja e Kuvendit amendamentohet dhe amendamenti i saj miratohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Mirëpo, paragrafi 2 i këtij neni shprehimisht përcakton që miratimi dhe amendamenti i Rregullores së Kuvendit bëhet sipas procedurës së paraparë për ligjvënje, që nënkupton se çfarëdo amendamenti i Rregullores, përfshirë edhe ndryshimin e nenit 69, komisionet e përhershme dhe komisionet funksionale, duhet bërë sipas procedurave të parapara në kreun 3, procedurat ligjvënëse, sipas së cilës edhe ndryshimi i Rregullores për numrin e komisioneve dhe ndryshimi i shtojcës nr. 2 për fushëveprimin dhe përgjegjësitë e tyre kërkon realizimin e të gjitha fazave legislative, siç përcaktohet në Rregullore.

Andaj, si grup parlamentar, me qëllim të respektimit të plotë dhe të duhur të Rregullores, kërkojmë që në seancën e sotme të mos provohet amendamenti i Rregullores, pa i kaluar ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Regjia, në qoftë se nuk janë përmbushur dhjetë minuta, atëherë ia zgjatni fjalën. Pasi ishte të deklarimet jashtë rendit të ditës, mirëpo tani është duke e shfrytëzuar kohën e tij për komision parlamentar, kështu që...

BEDRI HAMZA: Zonja kryetare, është fjalim bash për rendin e ditës...

KRYETARJA: Nuk ke nevojë të bërtasësh, zoti Hamza, po ju dëgjojmë mirë, po i sqaroj procedurat, në mënyrë që edhe ju t'i kuptoni drejt. Ne po tregojmë mirëkuptim përkundër faktit që ju patët të drejtë të mos e votoni rendin e ditës, por e votuat me vetëm dy pika në të, atë të propozuar nga Qeveria dhe atë të propozuar nga Kryesia. Por, kësaj radhe po tregojmë mirëkuptim, meqenëse e keni herën e parë, herët tjera i lexoni pak më mirë edhe merrni pjesë në mbledhje të Kryesisë dhe i tregoni qëndrimet e juaja. Regjia, edhe minutat e mbetur.

BEDRI HAMZA: Zonja kryetare, nuk të duhet kjo arrogancë, nuk të vyen kjo arrogancë, nuk e ke nisur mirë, keq e ke! Unë mendoj që e kemi thënë në seancën e parë që kohezioni i brendshëm i duhet këtij vendi. Ne jemi për kohezion të brendshëm, mirëpo në kohezionin e brendshëm më shumë ka përgjegjësi ta bëjë pozita sesa opozita.

Faleminderit për këshillën, për tonalitetin! Do të flas më butë, më qetë, me zë më melodik, por një dua të ta them, keq e ke nisur, ndërrohu! Nuk mundesh kështu me këtë arrogancë, se nuk të çon kurrkund!

Çështja e dytë që do ta ngre është pikërisht mbledhja e Kryesisë së Kuvendit për zgjedhjen e kryetares së Kuvendit. Na keni ftuar, zonja kryetare, na ka ftuar Kryesia në orën 18:26, e ka vendosur një precedent të keq, nëpërmjet një thirrjeje në “wiber” që mbledhja të mbahet në 18:30. Katër minuta kohë i kemi pasur si kryetar i grupit parlamentar, e si nënkryetar i Kuvendit për të marrë pjesë në atë mbledhje. Po, te dera sikur të kishim qenë, nuk do të mund të hynim. A kjo është mënyra e ftesës së mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit? E ky është një precedent i rrezikshëm.

Pastaj, për mbledhje të seancës jemi ftuar afërsisht në orën 19:00, apo pak pas orës 19:00. Si kemi mundur të jemi si deputetë të Kuvendit të Kosovës në këtë sallë? Jeni zgjedhur, zonja kryetare, për herë të parë pa praninë e opozitës dhe, a e di pse? Nuk e kemi bojkotuar seancën, s'e kemi bojkotuar as sot. Nuk jemi për opozitë në raport me shtetin dhe me interesin shtetëror, këtë e dëshmuam edhe më herët, edhe me praninë tonë, edhe me votimin tonë për vendimin për zgjatjen e ndarjeve buxhetore. Mirëpo, ju e keni përjashtuar opozitën prej seancës me mosthirrjen e seancës në përputhje me procedurat, me Rregulloren dhe me logjikën. Nëse del dikush prej deputetëve, pozitë dhe opozitë, dhe thotë “ndoshta e kanë ditur deputetët e opozitës që do të ndodhë kjo seancë”, por ne nuk e kemi ditur dhe nuk kemi marrë ftesë. Prandaj, e ke zgjedhur këtë rrugë, zonja kryetare, por e ke zgjedhur të jesh e zgjedhur edhe me votat e Listës serbe, është e drejtë, është parti politike në Kuvend, mirëpo më herët keni deklaruar që nuk keni marrëveshje, e po del që keni marrëveshje. Përndryshe, votat e kësaj partie politike në Kuvendin e Kosovës, që janë si të gjithë ne të tjerët, kanë qenë përcaktuese për zgjedhjen tuaj.

Përtej kësaj, zonja kryetare, je e obliguar, e detyruar, sikur të gjithë ne, që ta respektosh ligjin. Ke filluar me veprime jo të duhura. Nesër ju, apo dikush tjetër, kushdo qoftë, mund të jetë në një

institucion të lartë të këtij shteti. Duhet të sillemi me kulturë institucionale, prandaj shembullin që e ke marrë është model i keq, është precedent i keq dhe t'u kisha lutur që të mos i ngatërroni çështjet, sepse ne nuk jemi kundër që ju të inspirohemi, të mbani çfarëdo që juve ju pëlqen në zyrën tuaj, mirëpo je e detyruar ta mbash atë që ta përcakton ligji. Prandaj, të kisha lutur shumë, edhe kësaj radhe nuk ishte korrekte në raport me mua si kryetar i grupit parlamentar, edhe si deputet i Kuvendit të Kosovës. Shpresoj që në të ardhmen të mos përsëritet një gjë e tillë. Unë e di që juve dhe vendit, edhe pozitës, edhe vendit, i nevojitet kohezioni i brendshëm. Nuk krijohet në mënyrën qysh ju e keni filluar dhe ju keni qasur. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Po ashtu, nuk krijohet duke përdorur gjuhë joparlamentare, por po tregojmë pak tolerancë. Zoti Gashi e ka kërkuar fjalën. Urdhëroni!

ARBEN GASHI: Ju faleminderit, zonja kryetare!

Sa për sqarim, sa i përket seancës së jashtëzakonshme të thirrur për zgjedhjen e kryetares së Kuvendit, zoti Hamza, zonja kryetare nuk ka qenë kryetare, ka qenë njëra prej deputeteve në atë kohë. Seancën e kanë thirrur seancë të jashtëzakonshme Grupi Parlamentar i LDK-së dhe Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes. Dhe të gjithë deputetët janë njoftuar kur ka seancë të jashtëzakonshme me 40 nënshkrime, koha e seancës përcaktohet nga propozuesi.

Pra, përderisa ka qenë seancë e jashtëzakonshme, propozuesi e ka përcaktuar orën se kur duhet të mbahet seanca, dhe është mbajtur si e tillë.

Sa i përket rendit të ditës, më lejo të të njoftoj se neni 42 i Rregullores thotë: Përcaktimi i rendit të ditës - Kryesia në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare e përcakton rendin e ditës për mbledhjen e radhës të Kuvendit, rendi i ditës u dërgohet deputetëve etj. Nëse keni pasur propozim për plotësim-ndryshim të rendit të ditës, normalisht para se të votohet rendi i ditës, në kohën kur zoti Selimi propozoi plotësim-ndryshimin, edhe ju keni mundur të propozoni plotësim-ndryshim dhe ta futni në rend të ditës edhe pikën deklarime jashtë rendit të ditës. Praktika e mëhershme të çështja e komisioneve nuk ka pasur debate dhe nuk ka pasur deklarime jashtë rendit të ditës, as në mandatin e kaluar, dhe numri i komisioneve po ashtu edhe mandatin e kaluar ka qenë 14. Nuk ka ndryshuar numri i komisioneve, nuk është ndryshuar renditja e komisioneve. Çka ka ndryshuar është vetëm përmirësim i linjave të raportimit ndërmjet ministrive.

Pra, si përfundim, mund t'ju them se ajo çka ka ndodhur natën e zgjedhjes së kryetares së Kuvendit nuk është në përgjegjësinë e kryetares së Kuvendit, por është në përgjegjësinë e propozuesit. Në këtë rast, propozues kanë qenë Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje.

E dyta, sa i përket rendit të ditës, është kompetencë e kryetares dhe Kryesisë përcaktimi i rendit të ditës. Dhe, e treta, plotësim-ndryshimi i rendit të ditës ka mund të bëhet në fillim të seancës. Mund të bëhet edhe tani nëse keni diçka të jashtëzakonshme, mund të propozoni, nëse seanca e pranon mund ta marrim dhe ta trajtojmë si çështje të jashtëzakonshme në seancë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit z. Gashi!

Më lejoni po ashtu të sqaroj se edhe në mandatin e kaluar, në vitin 2017, kur është votuar konstituimi i komisioneve dhe zvogëlimi i numri të tyre nuk ka pasur deklarime jashtë rendit të ditës. Pra, ka qenë më shumë seancë funksionale, siç është edhe kjo sot. Në qoftë se shefat e tjerë të grupeve parlamentare nuk e kërkojnë fjalën...

Nga Nisma nuk e kemi askënd të paraqitur. Nga Lista serbe, shefi i Grupit Parlamenar, z. Simiq.

IGOR SIMIĆ: Poštovana presednica!

Uvaženi kolege poslanici,

O skladu sa dogovorom na Predsentištvu, a u vezi sa predlogom koji je dat, a kojim se poštuje politička snaga Srpske liste, odnosno brojem mandata u Skupštini i naša ustavna prava, mi ćemo podržati ovu tačku dnevnog reda. Hvala!

KRYETARJA: Zoti Hamza ka kërkuar replikë ndaj sqarimeve që i tha z. Gashi, po supozoj.

BEDRI HAMZA: Faleminderit për supozime zonja kryetare!

Po doje të shkosh shumë larg me supozime. Po, pikërisht për këtë. Ne nuk e thamë, as nuk e bartëm përgjegjësinë te kryetarja e Kuvendit për thirrjen e mbledhjes së Kryesisë. Ne iu referuam mënyrës së thirrjes së mbledhjes së Kryesisë. Nëse pozita aktuale dëshiron që të mos e lërë opozitën të marrë pjesë në seanca dhe në mbledhje të Kryesisë, i fton zakonisht mbledhjet në “wiber” në 18:26 për 18:30, apo seancat në orën 19:02 minuta, për seancat në orën 19:00, pa rend dite, pa ftesë deputetëve. Ky ishte shqetësimi ynë. Prandaj po ju lusim, edhe pse këtë ju ishte dashur ta bëni, që të krijoni një atmosferë të punës pozitive-opozitive, se për çështje të caktuara ne nuk dëshirojmë të jemi opozitë ndaj proceseve të caktuara. Përndryshe, mund të mos na ftoni fare. Shumicën e keni e dimë, por ndoshta nganjëherë ju duhemi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit z. Hamza! Jo nganjëherë, po besoj që në radhë të parë qytetarëve të Kosovës u duhet prania e secilit deputet.

E kanë kërkuar fjalën edhe shefat e tjerë të grupeve parlamentare për pikën e rendit të ditës. Megjithatë, nënkryetarja e Kuvendit e ka kërkuar fjalën për një sqarim rreth çështjeve të ngritura. Zonja Nagavci e ka fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër Kurti,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Zoti Hamza, ju falënderoj për ngritjen e çështjeve, edhe pse, më lejoni që t'ju njoftoj, në bazë të informatave zyrtare, d.m.th. edhe në dy seancat paraprake të Kuvendit, seancat plenare kur janë votuar komisionet në dy qeverisjet e kaluara, kur shumica ka qenë dhe janë udhëhequr nga PDK-ja, konkretisht më 18 dhjetor të vitit 2014 dhe më 3 tetor të vitit 2017, nuk ka pasur debat apo çështje për diskutim paraprak, ashtu siç e kërkuat ju. Po ashtu, për votimin e komisioneve nuk ka pasur fare debat. Kështu që e pranoj rekomandimin tuaj që ta rritim bashkëpunimin dhe ju mirëpresim në mbledhjet e radhës të Kryesisë, në mënyrë që me vendimet që i marrim bashkërisht të jeni të pranishëm dhe të vijmë në situatë që jemi konstruktivë për më tutje. Pra, besoj që të gjithë ne, dhe bashkë me kryetaren, do të sigurohemi që të kemi një respektim të plotë të ligjit dhe jam e sigurt që në këtë rast nuk ka asnjë shkelje, as procedurale, as ligjore.

Meqenëse e adresuat edhe çështjen e seancës plenare më 3 shkurt, kur u zgjodh kryeparlamentarja znj. Vjosa Osmani, ju njoftoj se e kemi pasur një kërkesë, personalisht kam pranuar kërkesën nga 40 deputetë të iniciuar nga Lidhja Demokratike dhe Lëvizja Vetëvendosje. Kërkesa, ashtu siç e dini, duhet të shqyrtohet. Njoftimi ju ka ardhur zyrtarisht të gjithë deputetëve, por i kemi edhe shkresat formale. Pra, nuk ka vetëm ftesë me “wiber”, ka një shkresë formale me të cilën jeni ftuar që të merrni pjesë në mbledhjet e Kryesisë dhe pastaj në Kuvend. E di se koha ka qenë e shkurtër, por kemi qenë të gjithë të pranishëm në seancë, me përjashtim që ju keni dalë prej seancës kur është votuar Qeveria.

Sido që të jetë, unë, duke pasur parasysh, besoj bashkë me të gjithë ju, rëndësinë e komisioneve dhe funksionalizimin e të gjitha komisioneve dhe vazhdimin të punës, për faktin se ka kaluar shumë kohë nga zgjedhjet dhe po ashtu nga dorëheqja e Qeverisë, duhet të procedoja me punë. Më vjen mirë që të gjithë ju e përmendët që dëshironi të mos e bllokoni punën e Kuvendit, atëherë ju ftoj që të vazhdojmë sipas rendit të ditës dhe të vazhdojmë me votimin për komisionet ashtu sikur është votuar edhe rendi i ditës fillimisht. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me shefat e grupeve parlamentare.

Prapë dëshiron replikë? Hajde, urdhëro z. Hamza!

BEDRI HAMZA: Po, sa herë të më takon, e kërkoj. Edhe nuk është kjo në nderin tuaj zonja kryetare a ma jep fjalën a jo, por është punë e Rregullores. Është punë e Rregullores, je e detyruar.

KRYETARJA: Zoti Hamza, përmbajuni pak, sepse i di fort mirë të drejtat dhe detyrimet sipas Rregullores.

BEDRI HAMZA: Jo, nuk po i di. Jo, jo, ti pretendon që po i di!

KRYETARJA: Dhe, në të njëjtën kohë kam të drejtë dhe kam pasur të drejtë në momentin që ju keni përdorur gjuhë joparlamentare gjatë kësaj seance, që të jua ndërpres fjalën.

BEDRI HAMZA: Cila ka qenë ajo? Cila?

KRYETARJA: Por, ju thashë që do të tregohemi tolerantë për shkak se jemi të interesuar që të gjithë deputetët e Kuvendit ta kryejnë detyrën e vet. Në qoftë se keni replikë ndaj temave që i shtroi zonja Nagavci, urdhëroni, merreni fjalën, i keni dy minuta.

BEDRI HAMZA: Zonja kryetare!

Nëse kam përdorur gjuhë joparlamentare, më trego cila është, unë kërkoj falje publike. Absolutisht! Edhe ndihem shumë keq me çfarëdo fjale që kam përdorur jashtë asaj që e duron ky Parlament dhe kjo foltore. Nuk kam përdorur gjuhë joparlamentare, kjo është shpikje juaja. Le të mbetet te ti.

Sa i përket qysh janë organizuar seancat në të kaluarën, nuk jemi duke iu referuar të kaluarës, se jemi duke folur për këtë mandat. Një pjesë e madhe e jona nuk kemi qenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ne nuk kemi marrë ftesë në mënyrë të rregullt as për mbledhjen e Kryesisë kur është përcaktuar rendi i ditës dhe koha për zgjedhjen e kryetares së Kuvendit. Le ta tregojë, dhe nuk kemi marrë gjithashtu ftesë në kohë dhe në mënyrën e duhur për organizimin e seancës. Prandaj, ju kisha lutur që kur thirreni për kohezion të brendshëm, ju në këtë mënyrë nuk mund dhe nuk jeni duke kontribuar në kohezionin e brendshëm. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Vazhdojmë me deputetët e tjerë që e kanë kërkuar fjalën.

Fjalën e ka deputeti Shkëmb Manaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Më falni, Grupi Parlamentar Nisma, në emër të grupit. Kërkoj falje, Shkëmb! T'i përfundojmë grupet parlamentare.

Grupi Parlamentar i AAK-së është deklaruar. Vetëm t'i kalojmë një herë, pastaj kthehemi edhe një herë te ju.

Nga Grupi Parlamentar Nisma, znj. Balaj-Halimi e ka fjalën.

ALBULENA BALAJ-HALIMI: Faleminderit znj. kryetare!

Unë desha fillimisht t'i them z. Hamza që duhet të jetë i lumtur që ka marrë ftesë në "wiber" katër minuta përpara, sepse ka deputetë dhe grupe parlamentare që nuk kanë marrë fare ftesë.

Pra, të tillë siç jemi ne. Gjatë rrugës për në Prizren e kam parë që ka një seancë në Kuvendin e Kosovës. Nuk e dija nëse jam deputete, apo jo. Pra, të jesh i lumtur, z. Hamza.

Ajo që tha pak më herët dhe që u cek që nëpër seanca të fillimit të legjislaturave të tjera nuk ka pasur debat për këto komisione, dhe unë them normalisht që s'ka pasur debat, sepse nuk ka pasur shkelje të Rregullores së Kuvendit. Prandaj, ne sot po bëjmë debat për shkak se ka shkelje. Dhe, propozimi ynë si Nismë është që edhe një herë të mbledhet Kryesia e Kuvendit, grupet parlamentare dhe të diskutojnë, të pajtoheni ose jo me mënyrën se si të vini në Kuvendin, ose në seancë. Për shkak se të vini me 14 komisione dhe të thoni se në seancë do të vendoset kjo, atëherë pse nuk keni ardhur me 16 komisione dhe të thoni hajde po vendosim për 14 komisione. Faleminderit!

KRYETARJA: Shefi i grupit tuaj parlamentar ka qenë i pranishëm në mbledhje të Kryesisë dhe është pajtuar me këtë formulë dhe me këtë numër, znj. Balaj-Halimi.

Zoti Haradinaj edhe një herë e keni fjalën në emër të grupit, në qoftë se dëshironi të deklaroheni për temën e konstituimit të komisioneve.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, por në emër të grupit do të flasë Teuta Haxhiu.

Megjithatë, jeni duke shkëmbyer replika. Besoj që veç jemi dakord që nëse dikush e merr fjalën tri herë, dikush asnjëherë, atëherë referoju numrave se shumë e saktë je. Është krejt e vërtetë që nuk jemi njoftuar për zgjedhjen e kryetares së Kuvendit me kohë dhe kjo më së shumti të dëmton ty, e jo neve. Është krejt e vërtetë që Lista serbe ka votuar për kryetaren e Kuvendit, dhe unë nuk i mohova të drejtat e komuniteteve, as mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Unë kërkoja vetëm sqarim për ta ditur për qartësi, se Lista serbe a është pjesë e koalicionit qeverisës a nuk është? Kaq! Edhe unë nuk këtu që pati ndonjë shkelje, apo nevojë për mbrojtje. Teutë!

KRYETARJA: Faleminderit! Lidhur me konstituimin e komisioneve, ju lutem! Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Sinqerisht kisha dashur të zgjidhesh me mëngjes, e të thuash mirëmëngjesi ditën kur je zgjedhur ti si kryetare e Kuvendit. Ndihej mirë që je kryetare e Kuvendit, por kisha dashur me mëngjes të zgjidhesh në orën 10:00, edhe në një seancë të rregullt, e jo natën. Edhe “të zgjedhesh”, e jo “të zgjidhesh”, se konsideroj se nuk ke qenë e lidhur, ashtu siç ka deklaruar znj. Nagavci në momentin kur je zgjedhur.

Tanimë kryetare kisha dashur një praktikë të mirë, më të mirë sesa ndoshta që ka qenë, sepse avancim është kur secila Qeveri avancon dhe jo kur ka kthim prapa siç po ndodh. Edhe në udhëheqje të seancave. Pra, praktika e heqjes nga rendi i ditës e pikës jashtë rendit të ditës ka

ndodhur, por ka ndodhur me arsytetime. Unë kur e kam parë që ju keni vendosur që seancat të jenë çdo të enjte, është një praktikë e mirë. Mbledhjet e Kryesisë të jenë çdo të hënë, është praktikë e mirë. Por, të mblidhesh vetëm me një pikë, vetëm sa për t'u takuar, unë konsideroj që është edhe shpenzim i buxhetit, sepse, në fund të fundit, kemi për t'i marrë do të holla të udhëtimit, kemi për t'i marrë do mëditje, edhe këto janë shpenzime kot. Sa për t'u takuar, le të hiqet ajo praktika, u takuam për t'u takuar, e u takuam për të mos u takuar.

Pra, të mos vazhdojë kjo me Kuvendin. Prandaj, të lutem, pikën jashtë rendit të ditës të mos e heqësh asnjëherë, mos dëgjo arsytetime kot, sepse dikush mund të tentojë ta mësojë, po nuk do të thotë që është mësues për gjithçka. Këto praktika të paktën të hiqen nga praktika e Kuvendit. Pra, pika jashtë rendit të ditës vetëm kur ka arsytetime, mund të ndodhë të hiqet në seancë, por jo herëve të tjera. Nuk kisha dashur ta shohë aq më tepër prej juve.

Kurse e drejta e deputetëve për t'u shprehur dhe shumë herë e kemi diskutuar ndoshta ka qenë pak kohë, sepse besoj që edhe ju vetë disa herë e keni deklaruar që deputetët kanë pak kohë në 30 minuta. Të rritet 30-minutëshi ndoshta edhe 30 të tjerë t'u jepet mundësi deputetëve dhe të kenë fjalime që janë me rëndësi, me interes për qytetarët, unë mendoj se do të ishte një praktikë e mirë. Sa i përket ndarjes së komisioneve, gjithmonë ka qenë praktikë që të dihet edhe numri i opozitarëve, edhe numri i atyre që janë në pozitë.

Vërtet nuk është që të ka bërë nder pse ju ka votuar Lista serbe, asnjë grimë, por të mos harrojmë se ka votuar, megjithatë edhe Qeverinë. Votim, mos harroni. Po flas për qytetarët që nuk dinë.

Të votohet është të marrësh pjesë në votim, për, kundër apo abstenim. Lista serbe e paçi me shëndet edhe këtë Qeveri, ka abstenuar. Ashtu ka qenë marrëveshja në heshtje. Në heshtje, por po kërkojnë shumë, po kërkojnë edhe të tërhiqet taksa. E të gjitha këto po shkojnë në heshtje.

Prandaj, kryetare, do t'ju lusja që vërtet të sjellësh praktika të mira dhe gjithmonë do t'ju përkrah, aty ku ka praktika të mira. Mos dëgjo kur nuk ka praktika të mira dhe mos kërko, pra u thua të tjerëve se nuk ke qenë 'e lidhur', por 'jam zgjedhur'.

KRYETARJA: Faleminderit, zonja deputete! Po e përsëris që të gjithë shefat e grupeve parlamentare që ishin prezentë në mbledhjen e fundit të Kryesisë janë dakorduar për këtë rend dite.

Ne nuk do të kishim asgjë kundër që të kishim edhe deklarime jashtë rendit të ditës. Ju patët mundësinë ta propozoni atë. Akoma keni mundësi që të propozoni që të shtohet një pikë e tillë në rendin e ditës, kurse po pajtohem me juve që do të duhej të ishte koha më e gjatë, por për fat të keq, kjo mund të ndryshojë në qoftë se e ndryshojmë Rregulloren.

Andaj, po shpresoj që ta arrijmë një pajtim ndërmjet grupeve parlamentare, në mënyrë që Rregullorja të ndryshohet me 2/3 edhe për këto tema procedurale që ju i përmendët.

Fjalën e ka kërkuar Shkëmb Manaj, deputeti i radhës. Vazhdojmë pastaj me të tjerët.

SHKËMB MANAJ: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit,
I nderuar kryeministër dhe anëtarë të kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Fillimisht dua të theksoj se pajtohem plotësisht me propozim-vendimin për riorganizimin e komisioneve parlamentare, që ndërlidhet edhe me riorganizimin e Qeverisë, respektivisht me zvogëlimin e numrit të ministrive.

Është e rëndësishme që ky propozim i komisioneve të përfshijë të gjitha fushat e resorëve qeveritarë, por paralelisht me këtë, edhe të mbulimit të punës së institucioneve, të komisioneve dhe të bordeve që i përgjigjen drejtpërdrejt Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në bazë të këtij propozimi që e kemi nga Kryesia e Kuvendit, vërejta se në asnjë prej këtyre komisioneve nuk është përfshirë Komisioni për Administratë Publike. Në përbërjen e mëhershme ka pasur një Komision Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Tani në propozimin e ri ka mbetur vetëm Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, duke mos qenë i përfshirë edhe Komisioni për Administratë Publike.

Unë konsideroj që Komisioni për Administratë Publike duhet të jetë pjesë e ndonjërit prej komisioneve parlamentare, jo vetëm për shkak të emërimit, po për shkak të funksionit që ka dhe kjo për dy arsye: e para, sepse Komisioni për Administratë Publike përfshin të gjithë fushëveprimin e Ministrisë së Administratës Publike, e cila edhe pse i është bashkuar me riorganizimin e Qeverisë Ministrisë së Punëve të Brendshme, e ka ruajtur emërtimin si Ministri e Administratës së Publike dhe e Punëve të Brendshme, si dhe e ka ruajtur të gjithë fushëveprimin e saj mbi Administratën Publike të Republikës së Kosovës. Prandaj, ky resor qeveritar duhet të mbulohet me komision parlamentar.

Dhe, arsyeja e dytë është që ky është komision funksional, të cilit i përgjigjet dhe i raporton Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si institucion i përcaktuar me Kushtetutë që i përgjigjet Kuvendit të Kosovës.

Prandaj, kërkoj nga ana juaj që të rishikohet ky propozim dhe Komisioni për Administratë Publike të përfshihet nga njëri prej komisioneve të mëposhtme, në kuadër të Komisionit për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, ku ka qenë edhe më herët, ose në kuadër të

Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitet, Rregullore të Punës dhe Mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsionit. Ju faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti deputet! Fjalën e ka zoti Memli Krasniqi nga PDK-ja.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Realisht sot do duhej të ishte një seancë që rendi i ditës të ishte qysh ka qenë gjithmonë. Ju kisha ftuar që të jeni e saktë dhe të mos manipuloni me të kaluarën. Më 3 tetor 2017 herën e kaluar i kemi themeluar komisionet dhe pika e parë e rendit të ditës ka qenë deklaratimet jashtë rendit të ditës.

Kjo tendencë, të nderuar udhëheqës të Kuvendit, në krye që keni dalë, të ngufatet debati është një tendencë, e cila juve nuk ju bën nder aspak, e këtij Kuvendi edhe më pak. E keni filluar mbrapshtë dhe do të duhej të ndryshoni në qasjen ndaj debatit në Kuvend.

Ftesa në mënyrë klandestinë e mbajtjes së seancës, për të cilën e konfirmuat nga të gjithë opozitarët, ju keni pasur marrëveshje mes vete, si LKD, Vetëvendosje, Lista serbe, minoritet, për atë edhe keni ardhur, se e keni ditur. Ndërkaq, ne të tjerët në opozitë s'kemi pasur asnjë informatë dhe për këtë arsye s'kemi qenë në Kuvend.

Të ftohemi për seancë, për mbledhje të Kryesisë, mua si nënkryetar në orën 18:32 për në 18:30, kjo nuk ka asnjë logjikë.

Ju i keni pasur numrat, i keni pasur 55 shqiptarë, 10 serbë, kanë mjaftuar për t'u bërë kryetare. Keni mundur të prisni deri të nesërmen, bile ishte zgjedhur për dritë e jo për terr. Sidoqoftë, vendimi juaj, ju mund ta arsyetoni sa të doni që ka qenë legal, juve jua ka zvogëluar legjitimitetin. Juve ju duhet më shumë, se neve nuk na hyn në punë se a zgjidheni natën apo ditën, me apo pa Listën serbe dhe a zgjidheni në mënyrë klandestine apo në mënyrë transparente.

Ajo, juve ju ka dëmtuar më së shumti si kryetare e Kuvendit, por si të them, e drejtë juaja.

Ju kisha lutur edhe për çështjen e sotme. Ju numrat i keni. Ne kemi qenë shumicë përpara, tash jemi në pakicën parlamentare. Arroganca e numrave është gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë një shumice parlamentare dhe kjo arrogancë do t'ju largojë juve prej mundësisë që ta keni një kohezion të brendshëm që na nevojitet për shumë situata në të ardhmen.

Ta keni parasysh, ne jua votuam, absolutisht krejt opozita, vazhdimin e zgjatjeve buxhetore. Ju nuk e keni votuar kur keni qenë në opozitë. Në shkurt të vitit 2019, kërkesën që e ka sjellë Qeveria, ja ku është ish-ministri, zoti Hamza, ju nuk e keni votuar. Ne i kemi pasur mezi 61 vota. Edhe atëherë është rrezikuar të mos paguhen pagat e mjekëve, e të arsimtarëve, të mësuesve, të

policëve, të zjarrfikësve, pensionet e të gjitha. Edhe atëherë janë rrezikuar dhe ju nuk e keni mbështetur një gjë të tillë, sepse edhe këtu keni bërë luftë politike. Ne, nuk e kemi atë qasje. Por, mos e vështirësoni me vetëdije, për shkak të arrogancës që i keni numrat.

Realisht, unë shpresoj që ishte gabim teknik, se nëse keni filluar që dikush t'i bëjë regjisë që ta zvogëlojë edhe minutazhin, kjo është e patolerueshme. Janë dhjetë minuta që i takojnë deputetit.

Unë po besoj që ishte gabim teknik, pse zotit Hamza iu lejuan vetëm pesë, se sot s'pati deklaram jashtë rendit të ditës. Sikur të kishte deklaram jashtë rendit të ditës, është pesë në emër të grupit, tre si deputetë, por sot ishte pika e dytë e rendit të ditës dhe kaq.

Është me rëndësi që të respektohet Rregullorja dhe kjo parasheh që në seancat e rregullta gjithmonë të jenë deklaramet jashtë rendit të ditës, sepse në fund të fundit, jo vetëm për deputetët e opozitës, edhe për deputetë të pozitës është pika e cila na krijon mundësi të ngremë çështje për gjëra, të cilat zakonisht nuk diskutohet në Kuvend, dhe do të ishte mirë të respektohet, atë bashkë me pyetjet parlamentare.

Në rregull, sot ende ndoshta s'ka pyetje parlamentare për këta ministrat që rishtas janë emëruar, por prej seancës së ardhshme do t'ju lusnim në mënyrë shumë parlamentare të mos përpiqeni që ta ngufatni debatin, sepse nuk mund t'ia arrini këtij qëllimi, vetëm sa do të rrezikoni, thjesht që ta agravoni situatën në këtë Kuvend, e që nuk besoj që i duhet.

Proceduralisht, ju mund të thoni çfarë të doni, por nuk është respektuar e gjithë procedura për ndryshimin këtu. Herën e kaluar kanë qenë 16 komisione. 16 komisione janë në Rregullore. Nuk është njëjtë emërtimi edhe ndryshimi i numrit. Ju po kërkon që të ndryshojë numri, ne parimisht dhe, siç tha zoti Hamza në emër të grupit, ne dhe për 12 jemi në rregull. S'ka të bëjë me kosto.

Ju lutem, s'ka të bëjë me kosto as zvogëlimi i Qeverisë dhe as zvogëlimi i numrave në komision, bile më pak.

Çka keni ndryshuar që i keni 15 ministri? Keni për t'i paguar 7 kabinete më pak, njerëzit s'do t'i qitni nga puna ju, nëpër ministri.

Nëse e bëjmë kalkulimin, për rreth 70 njerëz do të paguani paga më pak. Mirë keni bërë. Urime, suksese, të shpresojmë të ecë puna mbarë kur punoni mbarë, por kjo kostoja nuk është arsyetim. Në rregull është që të përpiqeni t'i zvogëloni komisionet që të ketë njëfarë funksioni të monitorimit të ekzekutivit, edhe pse 16 kanë qenë, 14 po bëhen. Në mandatin e kaluar në Rregullore e ke 16. Edhe, e mbështesë çështjen që ndërlihet me Komision për Administratën Publike.

Mendoj, që kjo ka qenë një gabim, kushdo që te ju në kabinet apo kushdo tjetër që është marrë në administratë, sepse Administrata Publike të mos e ketë një komision i cili merret drejtpërdrejt me të, mendoj që është e pakuptimtë.

Mua ma merr mendja që Administrata Publike duhet të jetë aty, ku pak a shumë ka qenë me qeverisjen lokale me mediat e me të tjera, por kjo mbetet që të vendoset më vonë.

Dhe, për fund, ju përgëzoj për nderimin e doajenes, të këngëtares më të jashtëzakonshme që ka pasur populli shqiptar, Nexhmije Pagarusha, vetëm se ju e nderuat me një këngë për të cilën ajo vetë ka kërkuar që të mos transmetohet. Kjo është një shkarje, një gabim që nuk duhej një kryetareje të Kuvendit t'i ikte.

Për videoklipin, zonja Pagarusha e ndjerë, qysh në mars të vitit 2012 publikisht ka kërkuar edhe nga televizionet që të mos transmetohet. Për këtë kanë shkruar mediat e asaj kohe. Mund t'i gjeni me një kërkim shumë të shpejtë. Do të duhej dikush, qoftë nga kabineti juaj, qoftë nga kolegët tuaj që janë marrë me kulturë në parti, po edhe ju vetë pse jo, ta dini që përkundër që është njëra prej këngëve më të mira që janë prodhuar në gjuhën shqipe, zonja Pagarusha e ndjerë ka kërkuar që ky videoklip të mos transmetohet, dhe ju e transmetuat sot në sallën e Kuvendit, me siguri pa qëllim, pro siç thotë populli, 'ruaju nga sevapit e mos hyj në gjynah'.

Kjo juve ju vlen edhe për çështje të tjera, të cilat po tentoni t'i bëni në raport me opozitën. Kështu që, gabimet e paqëllimshme ndoshta janë të arsyeshme, por ju lutem që në raport me opozitën të mos gabime të qëllimshme, sepse debati nuk mund të ngufatet. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Sa i përket çështje së miratimit të numrit të pikave të rendit të ditës për vitin 2017, unë iu informova ashtu siç u informova nga ana e administratës së Kuvendit, kurse për numrin e komisioneve, po e sqaroj edhe një herë.

Në mandatin e kaluar, me votim të Kuvendit të Kosovës është zbritur numri i komisioneve nga 16 në 14 për atë mandat, pra ai rregull ka vlejtur për atë mandat. Rrjedhimisht, neve na duhet votim i ri për ta zbritur sërish numrin e komisioneve nga 16 në 14.

Po pajtohem me vërejtjet që i dhanë deputetët lidhur me Administratën Publike dhe në qoftë se pajtohem, kur të vijë puna e votimit i bëjmë korrigjimet e nevojshme që të futet brenda Komisionit për Qeverisje Lokale, ku edhe ka qenë më herët dhe është komision më pak i ngarkuar në krahasim me atë për Legjislacion.

Fjalën e ka kërkuar deputeti Bekim Haxhiu nga PDK-ja. Përgatitet deputeti Armend Zemaj nga LDK-ja.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Përfaqësues të mediave,

Brenda kësaj periudhe kohore prej se jam deputet, për herë të parë ka ndodhur që për një seancë të thirrem në orën 19:02 për seancën e orës 19:00, dhe për herë të parë ndodh kështu.

Unë e shoh që edhe parashtuesi i kërkesës për seancë të jashtëzakonshme, zoti Gashi, kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, më shpejt ua ka shpërndarë ftesat në gjuhën serbe dhe komuniteteve të tjera se sa opozitës shqiptare.

Kisha pasur dëshirë të na e shpjegojë zoti Gashi se si u shkoi ftesa më shpejt komuniteteve, si u përkthye nga Administrata e Kuvendit, ftesa për komunitetin serb, për Listën serbe, edhe për komunitete të tjera, se sa për opozitën shqiptare, e para.

E dyta, po shihet që ka pasur një njohuri paraprake, d.m.th. të Listës serbe dhe ata kanë qenë të gatshëm të marrin pjesë. Prandaj, ju lutem, bëjeni publike marrëveshjen për qeverisje me Listën serbe.

Nuk është marre, edhe nëse keni bërë, po është marre nëse e fshihni marrëveshjen, sepse atëherë kjo rrezikon shumë çështje të tjera. Prandaj, bëjeni publike marrëveshjen me Listën serbe, sepse kjo është e domosdoshme dhe qytetarët dëshirojnë të dinë se çfarë përmban ajo marrëveshje, edhe neve si deputetë na intereson marrëveshja juaj me Listën serbe, sepse ajo mundësoi që të bëhet kryetare e Kuvendit Vjosa.

Unë po të drejtohem sot me Vjosë, këta mund të drejtohen me e ‘nderuar kryetare’, në momentin që t’i bësh me pozitës që e mban dhe e respekton ligjin për të gjitha çështjet të cilat janë, edhe deputetët e Parlamentit, të gjithë të barabartë dhe ju jeni vetëm një udhëheqëse e kësaj seance, asgjë më shumë e as më pak dhe nuk bën mirë me arrogancën, me të cilën jeni duke u sjellë.

Sa u përket çështjeve të komisioneve, nëse njëri prej komisioneve, sipas Rregullores i takon komuniteteve, atëherë mbesin 13, ndarja logjike do të duhet të ishte 7 me 6 pozitë sipas Rregullores me opozitë ose keni mundur të bëhet ndryshim, pasi po hyjmë te ndryshimi i Rregullores që ato të jenë konform ose mbikëqyrjes së Qeverisë, ashtu si janë bashkuar ministritë të jetë edhe komisionet me qëllim që të mbikëqyret gjithsecila ministri nga një komision veç e veç, mendoj që do të ishte një zgjidhje më e mirë se sa kjo e cila është propozuar tash. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Do të jetë nder për mua që të jem kryetarja juaj e Kuvendit për katër vjetët e ardhshme. Zoti Gashi e ka fjalën për replikë në raport me diskutimin e zotit Haxhiu.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Sa u përket pyetjeve të drejtpërdrejta të shtruara nga zoti Haxhiu, më duhet ta njoftoj se kërkesën për seancë të jashtëzakonshme e kam propozuar unë. Po ashtu më duhet ta njoftoj se unë kam biseduar me deputetët e mundshëm për të votuar. Po ashtu duhet ta njoftoj zotën Haxhiu se Partia Demokratike e Kosovës e ka lëshuar seancën shumë më herët, pra në momentin kur është votuar për Qeverinë dhe po ashtu dua ta njoftoj se unë nuk e di se kush i përkthen dokumentet dhe cila është procedura nga momenti kur unë e dorëzoj kërkesën.

Pra, unë në emër të Grupit Parlamentar Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje kam kërkuar seancë të jashtëzakonshme, siç e parasheh Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës, me 40 nënshkrime, në fakt, kanë qenë 42 nënshkrime, e kam drejtuar te Sekretari i Kuvendit, Sekretari i Kuvendit në bazë të detyrave të veta ligjore ka njoftuar institucionet e tjera dhe grupet politike.

Pra, mendoj se debatin tonë politik dhe luftën politike pozitive-opozitive të mos e orientojmë padrejtësisht drejtë pakicës serbe ose Listës serbe, si përfaqësuese në Kuvend.

Çështja e debateve tona, pakënaqësisë me pozitën apo opozitën, i trajtojmë mes nesh, çka do që ka përtej kësaj mendoj se është njëfarë strategjie e paarsyeshme dhe joproductive e krijimit të një perceptimi, sikurse ndodhi atje, një marrëveshje e fshehtë a çka.

Unë kam folur me përfaqësuesin e Listës serbe, me kryetarin e Grupit Parlamentar dhe i kam thënë se ne e kemi kandidaten për kryetare të Kuvendit, a jeni të gatshëm të merrni pjesë në seancë, më kanë thanë për 10 minuta ta kthej përgjigjen. Pas 10 minutave më kanë thënë, si shenjë e vullnetit të mirë, ne marrim pjesë në seancë, shumë mirë, faleminderit! E kam thirrur seancën, jeni njoftuar sipas procedurës të gjithë deputetët, besoj, nga Sekretaria e Kuvendit, është mbajtur seanca, është zgjedhur kryetarja e Kuvendit, jemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Kundër-replikë, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Faleminderit Arben, edhe për sqarimin, të cilën e dhe, edhe për atë që vetëm se treguat atë që unë kisha dyshimet e mia, se keni marrëveshje për qeverisje me Listën serbe, ju dhe Vetëvendosja. Prandaj unë e kuptoj edhe ngutinë, sepse vetëm sa e the ngutinë tuaj për ta votuar po atë natë

duke shkelur procedurat edhe Vjosa Osmanin është bërë mu për shkak të mosbesimit që e keni pasur mes vete. Ju nuk i keni besuar njëri-tjetrit deri në mëngjes të pritni për ta votuar Vjosën. Prandaj jeni ngutur ta bëni me votat e Listës serbe. Urime kryetare, edhe zgjedhja juaj me vetëm 48 vota të shqiptarëve kryetare e Kuvendit.

KRYETARJA: Faleminderit! Po e përsëris, do të jetë nderi im që do të jem kryetare e gjithë deputetëve të këtij institucioni të lartë përfaqësues. Zoti Armend Zemaj e ka fjalën. Urdhëroni, zoti Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Urime kryetare, suksese, shëndet edhe juve, edhe neve, edhe të gjithë deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës!

Realisht është legjislatura e katërt që ne punojmë me Rregulloren e vjetër të Punës së Kuvendit. Edhe ky debat nxjerr në pah që duhet të ekzistojë vullneti politik që ta bëjmë ndryshimplotësimin e kësaj Rregulloreje dhe deputetëve të rinj, legjislaturave të reja të mos u servohet Rregullorja e vjetër e Punës, edhe ashtu është e përcaktuar me Kushtetutë që çdo legjislaturë duhet ta ketë Rregulloren e vet të Punës së Kuvendit dhe kjo nuk është diçka e re.

Andaj, kushtimisht nga kjo, edhe debati që bëhet për përcaktimin e rendit të ditës është shprehimisht e shkruar, e sanksionuar në atë Rregullore, po ajo Rregullore nuk është mbi vullnetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nuk është mbi vullnetin tonë. 80 deputetë të këtij Kuvendi mund ta ndryshojnë edhe Kushtetutën, mund ta përcaktojnë edhe rendin e ditës, sepse këtë e ka përcaktuar sovranin, neve na ka besuar dhe nuk mund të na izolojë askush brenda atyre kornizave nëse nuk ka vullnet politik dhe, shprehimisht nëse nuk deklarohemi me votë për ose kundër.

Andaj deklaratimet për përcaktimin e rendit të ditës janë përcaktim edhe janë procedurë e Kryesisë së Kuvendit, edhe anëtarëve të Kryesisë së Kuvendit që janë deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe shfaqje të grupeve parlamentare, të cilët na përfaqësojnë neve dhe na japin orientime politike për një seancë plenare. Kjo nuk është diçka e re, nëse është diçka e re për deputetët e vjetër, më vjen keq, por edhe nga raporti nëse determinon apo del në sipërfaqe pozitive dhe opozitive, nuk do të duhej të ishte temë aq debatuese sot, se sa ta vëmë në funksion të plotë Kuvendin e Republikës së Kosovës përmes komisioneve parlamentare.

Numrin e propozon Kryesia, e përcakton dhe e vendos Kuvendi, edhe për emërtimet, edhe për fushëveprimtarinë, edhe për kompetencat dhe mbetet po ashtu të mos e përsërisë, vullneti i deputetëve se si do të punojnë dhe si do ta mbikëqyrin Qeverinë për një mandat katërvjeçar.

Andaj, edhe praktikatat e mira ndonjëherë duhet të bisedohen, të avancohen, por praktikatat e këqija mendoj që nuk duhen të përdoren.

Praktikat e këqija është e vërtetë që kanë filluar në legjislaturat e kaluara që Kryesia të vendosë me MSM e me thirrje të mbledhjeve dhe takimeve, kemi pasur seanca edhe në 11, 12 të natës, kjo nuk është diçka e re, mund të shfaqet sot si diçka e re për gjendjen e cila është krijuar, por është e padrejtë të thuhet që është imponim i tanishëm dhe i kësaj mazhorance, e cila tash ekziston në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kështu besoj që deputetët duhet të deklarohen për formimin e komisioneve parlamentare, ta vëjnë në funksion Kuvendin e Kosovës dhe tek atëherë, edhe dy pikat që për mua kanë qenë gjithmonë të rëndësishme: Deklarimet jashtë rendit të ditës, edhe Pyetjet parlamentare për Qeverinë të jenë pikat më forta për mbikëqyrjen parlamentare.

Nuk do të dëshiroja që asnjëherë, sidomos pjesa për deklarimet jashtë rendit të ditës të shndërrohet në atë thënien “Hajt pak” dhe kjo të mos u shërbejë qytetarëve të vendit, por të jetë si ballafaqim personal i deputetëve apo grupeve politike siç ka ndodhur në të kaluarën.

Kështu që ju kisha lutur si kolegë, edhe si grupe politike sot t’i themelojmë komisionet parlamentare dhe tek atëherë do të na jepet mundësia edhe neve si deputetë, edhe si grupe politike që të shprehin edhe opinionet, por edhe të ushtrojmë mandatin tonë përfaqësues përmes mbikëqyrjes parlamentare ndaj ekzekutivit dhe ndaj agjencive, të cilat i nënshtrohen kontrollit parlamentar. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zonja Kusari-Lila e ka fjalën.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetare!

Kënaqësi dhe privilegj i veçantë ta marr fjalën nga ti, kështu që urime në seancën e parë të rregullt të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Është interesant një anomali sot që po ndodh në seancën e parë të rregullt të kësaj legjislature. Po ankohemi për mungesë debati, përderisa po debatojmë. Deri tash u tha, u kritikua Kryesia e Kuvendit, gjegjësisht u kritikua rendi i ditës që nuk ka pasur deklarimet jashtë rendit të ditës, ndërsa ne jemi duke debatuar. E kuptuam gjithashtu që agjenda miratohet në Kryesi të Kuvendit, e bojkotojmë Kryesinë, por prapë dëshirojmë që ato mendime, të cilat i keni pasur për agjendën e Kryesisë të përfshihen. Me sa kemi pasur përvojë deri tash dhe askush nuk mund të lavdërohet që Kryesinë e Kuvendit ndonjëherë e kemi pasur me aftësi telepatike për të kuptuar se cilat janë idetë ose kërkesat e tjerëve që nuk janë prezentë. Po flasim se si duhet të ecim përpara, po e diskutojmë që është shumë e rëndësishme të krijojmë praktika të reja, por gjithsesi po i referohemi të kaluarës ose në vazhdimësi po sjellim shembuj të së kaluarës. U bojkotua votimi i Qeverisë, e po ka ankesa pse s’kanë qenë pjesëmarrës opozita në votimin e Kryetares së Kuvendit. Nëse ka mbetur ky merak ajo zgjidhet thjesht, tregohet me respekt, me punë, me angazhim të përbashkët, në agjendën e përbashkët.

Singerisht, si deputete e Kuvendit të Kosovës, si deputete e Republikës së Kosovës po ndihem keq si pjesëmarrëse e shumicës, jo shumicës politike, por shumicës etnike të shqiptarëve që secilën herë në debat këtu në Kuvend politikisht i përmendin pakicat joserbe dhe pakicën serbe. Domethënë, në vazhdimësi kur duam t'i referohemi diçkaje negative, themi pakicat joserbe, Lista serbe. Kisha dashur, kolegë, ne mes vete të shumicës siç jemi, nëse mund të dakordohemi që të gjithë jeni të barabartë dhe keni mandatin e marrë dhe nëse flasim për vota ose për fuqi politike, të bëjmë edhe debatin në atë aspekt. Tash është debati je zgjedh kryetare me votat e Listës serbe, a e kthejmë tash ne prapë shtatorin e 2017-ës dhe themi ju e keni pritur Listën serbe duke u kthyer prej Beogradit. Nuk është ideja aty, ideja është hajde nëse po duam ta hapim një kapitull të ri, po e hapim si duhet. Jemi të gjithë të barabartë si deputetë, të gjithë e kemi fjalën, edhe po e marrim fjalën edhe po e shohim që jemi duke debatuar, përderisa prapë po them po ankojemi për mungesë debati.

Mund të debatojmë në substancë çka është dialogu politik ose debati këtu, po s'kemi substancë përderisa s'kemi komisione funksionale, s'kemi substancë përderisa s'kemi mundësi t'u bëjmë pyetje parlamentare ministrave. Unë besoj që njëjtë sikurse ju opozitë, edhe ne pozita jemi të interesuar të shohim punën e ministrave. Hajde, t'iu mundësojmë këtyre që 40 ligje që kanë mbetur në gjysmë, që iu kanë kthyer Qeverisë, të vijjnë nëpër komisionet funksionale dhe aty të fillojmë punën. Ne mundemi, po pajtohemi të gjithë, po mendoj që po ekziston një parim që Komisioni për Administratë Publike duhet të gjendet mënyra qysh të kthehet, duhet të takohen shefat e grupeve parlamentare, duhet të kthehet se është një reformë e administrates, e cila e pret edhe qeverinë e re.

Por, që ajo është debat përmbajtjesor. A ka qenë lëshim teknik apo ka qenë lëshim i formës tjetër, po si lëshim është identifikuar dhe gjithsesi Komisionin për Administratën Publike duhet kthyer me titull vetë. Edhe kështu në përmbyllje po e shoh opozitën me një dinamikë shumë të përshpejtuar e keni marrë këtë opozitarizmin, tash askujt s'po dua t'ia përmend emrin, veç po dua të them një gjë: si maratoniste për maratona, për gjatësi, për distanca të gjata rekomandohet që fillimin të mos e kesh me turr të madh, të ruahen energjitë se do të shkojmë gjatë, jo një mandate, po dy mandate, kështu që gjithë këtë opozitarizëm që po doni ta tregoni në fillim, mos po digjeni në gjysmë të rrugës, e nuk është mirë, s'është mirë për demokracinë e Kosovës, mirë është një demokraci, e cila e ka opozitën e shëndoshë dhe diskuton për substancë dhe për çështje. Hajde, t'iu japim substancë edhe çështje, t'iu diskutojmë votimin e komisioneve parlamentare, në fakt shefat e grupeve takohuni si t'iu riemëruar, qitini në votim ecim përpara. Faleminderit!

KRYETARJA: Nuk ia përmendi emrin asnjë deputeti, opozitën në tërësi e ka përmendur, mirëpo për opozitën në tërësi besoj shefat e grupeve mund të deklarohen, unë po vazhdoj me deputetët që e kanë kërkuar fjalën. Është nga LDK Vlora Limani Hajnuni, përgatitet Uran Ismajli nga PDK.

VLORA LIMANI-HAJNUNI: Faleminderit kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nder dhe kënaqësi e veçantë, zonja kryetare, të marr fjalën prej teje, për herë të parë ky institucion udhëhiqet nga një grua dhe natyrisht që do duhej të ishte privilegj për të gjithë neve, në veçanti, për gratë në këtë Kuvend.

Po diskutohet në vazhdimësi, sinqerisht mua më vjen keq, i njëjti diskurs publik i përdorur në legjislaturat e kaluara po vazhdon të përdoret edhe në këtë legjislaturë, duke i përdorur pakicat si argument të popullzimit për të marrë vota dhe për t'i vendosur si argumente politike. Vazhdimisht gjatë këtyre debateve u ankuan që s'po na lejohet me debatua derisa po debatojmë dhe në të njëjtën kohë, u ankuan që po shkelet Rregullorja e Punës së Kuvendit, e në ndërkohë vetë ne po e shkelim Rregulloren e Punës së Kuvendit, sepse ne ishim ata si deputetë, të cilët e votuam rendin e ditës dhe në ndërkohë, domethënë pa vërejtje, nuk propozuam rend tjetër, pikë tjetër shtesë të rendit të ditës dhe, në ndërkohë ndërhyrje në rendin e ditës, duke e spostuar debatin krejt jashtë trupave të Kuvendit dhe duke spostuar debatin në diskursin popullor publik. Ne jemi këtu që konsideroj të zgjedhim trupat e Kuvendit që janë komisionet, të cilat do të përdoren nga Kuvendi për mbikëqyrje të punës së Qeverisë, dhe prandaj unë mendoj që ne duhet të fokusohemi në këtë debat dhe në vërejtjet, të cilat u dhanë paraprakisht edhe për përbërjen e këtyre komisioneve, gjegjësisht çështjen e Komisionit të Administratës Publike. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Uran Ismajli e ka fjalën!

URAN ISMAJLI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Po e shoh që ka një dëshirë nga pak edhe të dëshmojnë ndoshta disa deputetë para grupeve të tyre dhe po i harrojnë rregullat fare. Ne jemi duke folur për çështje shumë të sakta, kemi shkelje të rregullave, kemi thirrje të cilat nuk janë respektuar, kemi seancë, e cila është bërë pa praninë e deputetëve, kemi thirrje të cilat kanë ndodhur në 19:02 minuta, kur seanca është mbajtur në orën 19:00.

Po ashtu, e keni një dëshirë të madhe të ngufatet debati dhe arsyen pse po debatojmë nuk është pse ju patët dëshirë të na lini të bëjmë debat, përkundrazi ju në fjalën e parë të zotit Hamza tentuat ta ndalni debatin, tentuat të krijoni një lloj krize kinse po përdor fjalë joparlamentare për të mundur t'ia ndalni debatin. Pra, unë nuk po e kuptoj çka është natyra juaj të krijoni këtë situatë, në të cilën opozitën e thirrni pas seancës, tentoni të kontrabandoni seancë, rend të ditës pa rregulla dhe tani vini na thoni është mirë të krijojmë një substancë. Cilën substancë, po e doni kur as plan program nuk po shohim ne të Qeverisë. Qysh mund substancë të kesh, shiko çfarë gabimi logjik bën. Thotë “po e krijojmë një seancë”, kur ne nuk na është sjellë as plan programi i Qeverisë, qysh mund ta kontrollosh Qeverinë, kur ty s'të ka sjellë as nuk e di për çka do të punojnë. Sot, jemi këtu duke tentuar të tregojmë që jeni duke u munduar me një çudi të madhe,

me një inat të madh po tentoni të ndalni zërin e opozitës. Ne votuam dhe treguam që votojmë për çështje të rëndësishme të shtetit, ashtu qysh nuk keni votuar ju. Kjo është shembulli më i mirë të vërehet çfarë dallimi jemi duke pasur. Ne kemi votuar kur ka ardhur çështja e buxhetit, ju jeni larguar nga ai votim herën e kaluar.

Çështjen etnike, shiko, unë prapë po e kuptoj që ka nevojë të dëshmoheni nga pak. Çështjet etnike nuk i kemi sjellë ne në Kuvend, i ka sjellë lideri juaj, mos harro. Domethënë, ne çështjet Albin Kurti ka folur çështjet etnike të parat, s'po dua t'ia nis t'i përmend prapë, filloni të kërkonit falje për fjalën “çetnik” e gjithçka çka u keni thënë, pastaj na thoni neve a bën t'u themi, kolegë i ke pasur edhe atëherë. A i ke pasur kolegë edhe atëherë, a veç tash i ke kolegë? Pse atëherë nuk e ke ngritur zërin? Pse po e ngrit zërin tash? Pra, në këtë rast unë jua kuptoj edhe maratonat politike, jua kuptoj edhe ndryshimet e adresave, e di që keni maratonë politike prej një partie në një parti, edhe atë jua kuptoj, por nuk po jua kuptoj ndryshimet e parimeve kaq të mëdha. Pse po i ndryshoni parimet gjithmonë? Nuk ka mundësi Kuvendi i Republikës së Kosovës, organi më i madh ligjvënës të jetë në kundërshtim me rregulla, në qoftë se Kuvendi i thyen rregullat, nuk e kuptoj çka pritni, çfarë ligji të sillni. Pra, respektoni rregullat, respektoni opozitën, mos u mundoni të udhëheqni me këtë lloj inati, i cili po shprehet dhe është shumë çudi e madhe. Nuk e kuptojmë çka po ndodh të krijoni kesi lloj mungese debati, këso lloj tendence negative ndaj opozitës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Për kundër-replikë e ka kërkuar fjalën zonja Kusari-Lila, por për korrektësi...

(Debat në sallë)

...për korrektësi ne jemi duke debatuar që dy orë. Askush nuk po e ndal debatin, përkundër faktit që ka pasur një listë të qartë të pikave të rendit të ditës, të pajtuara nga të gjithë shefat e grupeve parlamentare dhe anëtarët e Kryesisë që ishin prezentë.

Sqarimi tjetër, dokumenti nga administrata që iu referova më herët qenka nga viti 2014, si shembull, meqenëse seancat ku konstituohen komisionet janë kryesisht seanca funksionale. Rrjedhimisht, për t'u bërë Kuvendi plotësisht funksional dhe për të debatuar për çështje për të cilat ju po propozoni dhe të gjithë do të donim, ne duhet së pari t'i kemi komisionet funksionale. Por, debat mund të bëjmë sa të doni përderisa jemi përbrenda pikave të rendit të ditës.

E kanë kërkuar fjalën edhe katër deputetë. Është zonja Kusari, e përmenda për shkak se iu referua diskutimit të saj, por meqenëse më herët nuk e dhashë fjalën pa u përmendur emri, po e përmbaj të njëjtin rregull. Fjalën e ka Daut Haradinaj nga AAK, përgatitet Shpejtim Bulliqi nga Vetëvendosje.

DAUT HARADINAJ: Kryetare, faleminderit!

E para, mos i merr gjërat personale, sepse po jep shpjegim për çdo qëndrim të deputetëve, kështu që personalisht të përgëzoj për detyrën dhe të uroj suksese!

Si opozitë, propozimin e parë edhe jashtë rendit të ditës, që e solli pikërisht ekzekutivi, ne votuam për, në këtë rast për vazhdimin e buxhetit për 30 ditë. Do të thotë, ne e dhamë një argument që jemi konstruktivë. Por, disa deputetë këtu janë duke u munduar të na tregojnë neve se kush i mbron të drejtat e komuniteteve dhe kush po i “atakon”. Këtu jemi subjekte politike. Lista serbe janë subjekt politik i certifikuar në Republikën e Kosovës dhe ne e kemi një pyetje shumë të thjeshtë, a janë apo s’janë pjesë e koalicionit qeverisës? Kjo nuk po i adresohet kryetares së Kuvendit, sepse kryetarja e Kuvendit nuk ka bërë koalicion ekzekutiv në Qeveri, por po u adresohemi atyre që janë përgjegjës.

Një parafolëse tha, “mos u ngutni se tash jemi ende në gjysmë të mandatit”. Po, sot u bë një javë, shpejt e paskeni gjysmën. Lëre edhe ndonjë ditë. Por, unë e përgëzoj se ia ka sjellë fitoren Vetëvendosjes. Bile të paktën ta kisha parë në ekzekutiv e t’ia shohë hairin Gjakova.

KRYETARJA: Faleminderit! Shpejtim Bulliqi e ka fjalën. Zoti Haradinaj, nuk po i marr aspak personale. Kryesisht ishin sqarime procedurale. Juve personalisht ju falënderova për korrektësinë. Çështjet që i sqarova kanë të bëjnë me pikat e rendit të ditës dhe me faktin që, përderisa kemi akuza që po ndalet debati, ne jemi duke debatuar që dy orë dhe do të debatojmë sa të doni, përderisa arrijmë ta bëjmë Kuvendin funksional, ky është qëllimi. Fjalën e ka Shpejtim Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Të respektuar kolegë deputetë,

Nuk pata në plan ta marr fjalën, por po e shohim që përkundër faktit që kjo seancë mendoj se filloi mirë, me futjen në rend dite të një pike, e cila mendoj se ishte e rëndësishme për këtë seancë dhe po shohim që pak a shumë fjalimet e kolegëve dhe kolegeve deputete po shkojnë më shumë në atë kuptimin e fjalimeve politike, se sa që janë fjalime të cilat kanë të bëjnë me këtë rend dite, që faktikisht është i propozuar këtu. Duke marrë parasysh që jemi në fillim të punës së Kuvendit, ndoshta do të ishte mirë që këto fjalime politike t’i lëmë për më vonë, sepse besoj se do të kemi kohë të mjaftueshme.

Ne edhe ashtu kemi thënë se ky mandat do të jetë i plotë, por përveç këtij mandati, shpresojmë që edhe në mandatin e dytë bashkërisht të jemi në këtë Kuvend, në këtë formë kështu. Prandaj, besoj se do të kemi kohë të mjaftueshme që të diskutojmë, të japim vërejtje, të japim sugjerime për çdo gjë. Është mirë që sot të jemi brenda kësaj pike të rendit të ditës, ta japim kontributin tonë, në mënyrë që t’i zgjedhim trupat e Kuvendit dhe pas zgjedhjes së këtyre trupave të

Kuvendit, mendoj se do të kemi kohë të mjaftueshme të merremi me të gjitha problemet që mendojmë se janë të rëndësishme për qytetarët e vendit.

Në radhë të parë, unë mendoj se Kuvendi i Kosovës nuk e ka këtë komoditet që ta stërzgjasë çështjen e zgjedhjes dhe konstituimit të trupave të Kuvendit, prandaj e dimë që çështja e buxhetit është imediate për vendin, kështu që është mirë sot ta japim kontributin edhe pozita, edhe opozita, që t'i zgjedhim këto trupa punuese dhe më tutje çdonjëri ta luajë rolin e vet konform detyrave që i ka brenda këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Veton Berisha, por dua t'i lus shefat e grupeve parlamentare të ofrohen për një konsultim të shkurtër lidhur me vazhdimin e seancës.

VETON BERISHA: Faleminderit, kryetare Osmani!

Zonja kryetare, meqenëse unë nuk kam pasur rastin të të votoj dhe të uroj në ditën kur je zgjedhur kryetare, tash e shfrytëzoj rastin të ta uroj dhe të dëshiroj punë të mbarë. Po ashtu, jam një prej deputetëve që nuk kam marrë ftesë për të qenë pjesë e asaj seance. Fatkeqësisht! Kisha dëshiruar vërtet t'ju votoj, por nuk e kisha këtë rast dhe shpresoj që tjera herë do të marrim ftesa me kohë.

Dua ta paraqes kërkesën time që nga Kryesia të merret parasysh që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve është një komision funksional dhe i cili në mandatin e tij ka të bëjë me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve. Në këtë rast, meqenëse ne tashmë jemi duke u pozicionuar kah opozita dhe duke u pozicionuar kah mospërcaktimi ynë si grup parlamentar, megjithatë ne përfaqësojmë komunitete të caktuara. Unë jam përfaqësues legjitim i komunitetit egjiptian dhe të njëjtën kohë kërkoj nga Kryesia që të trajtojë kërkesën dhe pozitën e komunitetit egjiptian në kuadër të këtij komisioni.

E pashë se as deputeti që është në Lëvizjen Vetëvendosje nuk është në këtë komision, mendoj që ky komision duhet të përfaqësohet nga një përfaqësues i komunitetit egjiptian, në këtë rast kërkoj nga Kryesia që të trajtohet kërkesa ime që pavarësisht pozitës sime, në kuadër të cilit grup dhe cilit pozicion, kërkoj që të jem pjesë e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, me të vetmin qëllim t'i përfaqësoj interesat e komunitetit egjiptian, të cilin unë e përfaqësoj. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Berisha! Fjalën e ka shefi i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zoti Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zonja kryetare!

Në gjithë diskutimet që u bënë sot këtu, nuk është se nuk pati propozime konkrete, që e bënë të nevojshme një takim të kryetarëve të grupeve parlamentare, të ftuar nga ju, zonja Kryetare.

Prandaj, unë propozoj që ju të na ftoni në një takim e t'i shqyrtojmë të gjitha ato që u diskutuan sot dhe t'i përfshijmë. Me respekt, edhe të opozitës, unë mendoj se kemi çka të diskutojmë.

KRYETARJA: Propozimi juaj është që të bëjmë pauzë tani, zoti Selimi?

REXHEP SELIMI: Po. Propozimi im konkret është që ta bëjmë tash një pauzë dhe të takohemi kryetarët e grupeve parlamentare, bashkë me ju, për t'i diskutuar çështjet, para se të shkojmë në diskutim.

KRYETARJA: Fjalën e ka zoti Gashi nga LDK-ja.

ARBEN GASHI: Mendoj se është propozim i arsyeshëm. Nëse konsiderohet kështu, atëherë e përkrah propozimin. Faleminderit!

KRYETARJA: Zoti Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike mendon se diskutimet janë harxhuar, nuk ka më diskutime dhe kërkojmë që kjo çështje të vendoset në votim. Është në të drejtën e deputetëve të votojnë sipas bindjeve të tyre.

KRYETARJA: Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Edhe grupi ynë parlamentar mendon njëjtë, pra që të hidhet në votim, meqë diskutimet kanë përfunduar.

KRYETARJA: Zoti Shala nga Nisma-AKR e ka fjalën.

HAXHI SHALA: Edhe ne si grup mendojmë që debati u krye në këtë seancë dhe duhet të hidhet në votim. Për ose kundër, të vendosin deputetët se çka vendosin për të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARJA: Të lutem zoti Shala, ofroje mikrofonin se nuk po dëgjohesh.

HAXHI SHALA: Edhe grupi ynë mendon që debatet veç u kryen në seancë, dhe kjo pikë duhet të hidhet në votim dhe të vendosin deputetët se çka do të bëjmë. S'kemi çka konsultohemi më. Edhe u konsultuam me juve, zonja kryetare, kështu që kjo pikë duhet të hidhet në votim.

KRYETARJA: Fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi. Gabim qenka ende Emilija. E lus Administratën që ta bëjë këtë zëvendësim.

Nga Grupi 6+, e dëshiron dikush fjalën për t'u deklaruar rreth propozimit të z. Selimi? Urdhëro! Albert Kinolli e ka fjalën.

Mund të dilni në foltore z. Kinolli, meqenëse edhe ashtu si duket e paskëshit kartelën e zonjës Rexhepi.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, kryetare!

Mendoj se për këtë pikë të rendit të ditës është shteruar debati, dhe ne jemi për këtë rend të ditës që të hidhet në votim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Unë e kam një propozim që të dalim nga kjo situatë. Meqenëse konstituimi i komisioneve zakonisht është një vendim që i unifikon të gjitha grupet parlamentare, pavarësisht a janë ata përfaqësues të koalicionit qeverisës, apo të opozitës, dhe është çështje krejtësisht procedurale e funksionalizimit të Kuvendit të Kosovës, dhe po ashtu duke pasur parasysh që akoma jemi minus 12 deputetë dhe Presidenti i Republikës nuk po e kryen detyrën e tij kushtetuese që gjashtë ditë që ta nënshkruajë, pikërisht pse e keni sjellë këtu ma përkujtuat që t'ia përkujtoj që ta përfundojë detyrën e tij kushtetuese dhe të mos e bllokojë funksionalizimin e Kuvendit, por t'i nënshkruajë apo t'i dekretojë 12 emrat e deputetëve që nuk i takojnë vetëm koalicionit qeverisës, por edhe opozitës.

Dhe, po ashtu, duke pasur parasysh që kemi disa vërejte, e njëra që ka të bëjë me emërtimin, tjetra që ka të bëjë edhe me përbërjen e njërit nga komisionet, propozimi im është që këtë temë pra ta përfundojmë, ta shtyjmë për një ditë tjetër, dhe mbledhja e Kryesisë, në të cilën natyrisht të gjitha grupet parlamentare, si gjithnjë do të jeni të ftuara, do ta caktojë ditën dhe orën e saktë se kur vazhdojmë me votimin për konstituimin e Kuvendit.

I lus shifat e grupeve që të deklarohen rreth kësaj teme, edhe pse e kam në diskrecion që të vendos, por megjithatë meqenëse është seanca e parë që e drejtoj, po ju lus që të deklaroheni rreth kësaj.

Zoti Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Megjithëse, po ashtu siç thatë ju, është në dorën tuaj dhe në kompetencat tuaja që ta ndërpritni ose ta shtyni vazhdimin e seancës për një moment tjetër, unë siç thashë edhe një herë, në bazë të diskutimeve, e në bazë edhe të arsyeve që u dhanë këtu, mendoj që është shumë e nevojshme edhe një konsultë dhe vazhdimi i kësaj seance të bëhet në një ditë më të përshtatshme kur e vlerësojnë të gjithë së bashku.

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Për hir të korrektësisë, tash më duhet t'i them edhe disa gjëra të tjera të tjera që nuk i patë në plan t'i them. E para, nëse ne nuk e votojmë përbërjen e komisioneve, nuk është problem, se herën tjetër i lëmë 16 edhe vazhdojmë me 16 qysh janë në Rregullore. Pra, nëse ideja e bllokimit të opozitës është kjo, jemi në rregull.

Për korrektësi, po ua kujtoj disa prej kryetarëve të grupeve parlamentare të opozitës që kanë marrë pjesë në mbledhjen e Kryesisë, unë në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës kam propozuar që njëri prej katër komisioneve të përhershme të mbetet për Partinë Demokratike të Kosovës. Opozita, që sot po thotë që nuk do të votojë, nuk ka pranuar. Kanë heshtur. I kam vetë tri herë, a po e lëmë një komision kryesor për Partinë Demokratike të Kosovës? Nuk fliste askush. Po e lëmë për Partinë Demokratike të Kosovës njërin prej komisioneve të përhershme, tri herë i kam pyetur, kanë heshtur. Ndërsa sot po paraqiten si një aleancë opozitare, edhe pse kanë zgjedhur dhe janë favorizuar partitë opozitare. Mua më vjen që Partia Demokratike e Kosovës nuk ka marrë pjesë në Kryesi.

Unë mendoj që Partia Demokratike e Kosovës është dashur të jetë pjesë e Kryesisë dhe të zgjedhë në bazë të rendit zgjedhor. Partitë e tjera të opozitës janë të favorizuara. Sot po duan të bëjnë obstrukcion në Kuvend, le ta vazhdojnë obstrukcionin, ne i vazhdojmë atëherë funksionet tona dhe detyrat tona kushtetuese. Nëse Partia Demokratike e Kosovës deklarohet kundër kësaj ndarjeje, unë e respektoj. Ne seancën tjetër mund të vazhdojmë me 16 komisione, se ne e kemi një problem, ne e dimë, s'kemi nevojë ta fshehim. Na mungojnë 11 deputetë për shkak se Presidenti akoma nuk e ka dekretuar listën për në Kuvend. Pra, mungesa e këtyre 11 deputetëve na e vështirëson punën. E presim punën. Nëse nuk doni, nëse mendoni që nuk është në rregull kështu, unë jam shumë dakord me ju. Po nëse e doni veç si obstrukcion, po më duket i paarsyeshëm, po gjithsesi prapë e respektoj.

Pra, po jua përsëris, për hir të korrektësisë, kam kërkuar që njëri prej katër komisioneve të përhershme të mbetet për Partinë Demokratike të Kosovës. Njëri është i rezervuar për komunitete, kanë mbetur tri. Unë kam kërkuar që një të mbetet për PDK-në, partitë e tjera të opozitës kanë heshtur, kanë thënë vazhdojmë se ne jemi në rregull. Ndërsa tash në konsultim thonë që ne nuk marrim pjesë në votim ose votojmë kundër. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Hamza e ka fjalën.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja kryetare!

E para, mosprania e 11 deputetëve prapë se prapë nuk jua bën votat, edhe sikur të ishin në sallë. Edhe sikur të ishin në sallë, s'është tema kjo. Çështja është se ju e keni thirrur këtë seancë me këtë pikë të rendit të ditës. Ne iu referuam neneve specifike të Rregullores, çka kërkohet për t'u bërë plotësim-ndryshimi i Rregullores? Përtej kësaj, ne si grup parlamentar asnjë shqetësim nuk e ngritëm, as për numrin e komisioneve, as për ndarjen e komisioneve. Përtej kësaj, ne jua kemi

dërguar emrat për komisionet. I ka pranuar Kryesia e Kuvendit, besoj në mënyrë zyrtare emrat e të propozuarve nga Partia Demokratike.

Nuk jemi ne duke e diskutuar këtu as ndarjen e komisioneve, as përbërjen e komisioneve. Ne iu referuam bazës legale se çka kërkohet për t'u bërë ndryshimi i Rregullores. Kërkuam dhe sqaruam që disa procedura nuk janë respektuar dhe ku kërkohet kohezion i brendshëm, nuk mund ta kesh kohezionin e brendshëm dhe arrogancën në të njëjtën kohë. Nuk shkojnë këto dy gjëra bashkë. Prandaj përgjegjësia është e juaja. E keni thirrur seancën.

Përtej kësaj, zonja kryetare, është e padrejtë ta komentosh secilin diskutim të secilit deputet. Nuk është aspak korrekte t'u referohesh deputetëve për sende të caktuara. Nuk po dua të lëshohem në detaje. Është seanca juaj e parë, edhe besoj që e vërejtët me kujdes që unë si kryetar i Grupit Parlamentar dhe si deputet i Kuvendit të Kosovës t'u drejtova me respekt, “zonja kryetare e Kuvendit”. Prandaj, e keni vendosur në rend të ditës, e diskutuam, diskutimet u harxhuan, ne kërkojmë që e njëjta të vendoset për votim. Nëse kalon, ne i përmbahemi, nëse s'kalon është punë juaja për t'i bërë numrat dhe të kalohet Rregullorja. Faleminderit!

KRYETARJA: Po ju rekomandoj që të mësoheni me këtë mënyrë të drejtimit të seancave në përputhje të plotë me Rregulloren e Kuvendit. Kjo është e para. E dyta, ne natyrisht e sqaruam disa herë që ndryshimi i numrit të komisioneve bëhet duke e ndryshuar Rregulloren me 2/3, dhe synimi nuk është të bëhet ndryshe.

Fjalën e ka zoti Haradinaj nga AAK. Bëhet gati zoti Shala nga Nisma.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Nuk po dua t'i përsëris fjalët. Arbeni çka tha, është krejt e vërtetë që ka kërkuar një komision të përhershëm për Partinë Demokratike të Kosovës, por në rast se e marrim transkriptin e shohim që unë kam thënë decidivisht nuk është mirë të ndahen komisionet pa praninë e partisë më të madhe opozitare.

Do të thotë, këtu nuk është duke u kontestuar barazia e komisioneve dhe nuk po shoh që dikush ka vërejtje në ndarjen e komisioneve. Tekefundit, unë, nëse ju e vlerësoni, hidheni në votim. Ju e dini që 81 vota ju duhen, në rast se kalon, mirë, në rast se nuk kalon e sjellim në seancën e radhës.

Ose e kundërta, e patëm një propozim të Rexhep Selimit, të shefit të Grupit të VV-së, tha ta shtyjmë. Ju tani e keni në kompetencë të vendosni, por gjithsesi duhet ta shfrytëzojmë praktikën e mirë, si kryetari i Kuvendit, Kryesia e Kuvendit, kryetarët e komisioneve, duhet ta kenë një unitet në përzgjedhjen e tyre.

Kjo ka qenë edhe në praktikat e kaluara në shumicën e rasteve dhe unë e favorizoj që të kemi një përzgjedhje, të paktën funksionimi i Kuvendit të jetë unik.

Dhe, krejt në fund, Grupi Parlamentar i Aleancës ka jashtëzakonisht respekt për ty, edhe për qëndrimet në të kaluarën, e besoj edhe në të ardhmen për shumë tema.

Dihet fare mirë, bojkoti i Partisë Demokratike ka filluar për shkak të heqjes së fotografisë së Hashim Thaçit, presidentit të Republikës së Kosovës, dhe këtë duhet ta thonë këta zotërinjtë me zë.

Partia Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës po thotë edhe një herë dhe hapur po e themi hidheni në votim, nëse i keni numrat ecim tutje, s'i keni numrat, shihemi në seancën e radhës.

KRYETARJA: Fjalën e ka Haxhi Shala.

HAXHI SHALA: Faleminderit, kryetare!

Edhe ne si grup, në mbledhjen e Kryesisë jemi pajtuar që t'i kemi 14 komisione, jo 16, siç e citoi zoti Gashi. Njëkohësisht si grup ne u dakorduam që të hidhet në votim, nuk jemi ne që e bojkotojmë votimin, siç tha zoti Gashi.

Kështu që kisha kërkuar nga ju zonja kryetare që të hidhet në votim kjo pikë e rendit të ditës.

KRYETARJA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, meqenëse nuk ka më të paraqitur për debat, atëherë po vazhdojmë me propozimin.

Në përputhje me Rregulloren, të pranishëm janë 102 deputetë. Për ta ndryshuar Rregulloren, pra për ta ndryshuar numrin e komisioneve nga 16 në 14, nevojiten 2/3 e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Në qoftë se nuk ndryshon ajo dispozitë, atëherë mbeten 16 komisione.

Natyrisht që Kuvendi mund të procedojë pastaj edhe me 16 komisione. Megjithatë, qëllimi ynë i përbashkët dhe i të gjitha grupeve parlamentare atë ditë, siç edhe dëshmohet në transkript, ishte që ta bëjmë Kuvendin më funksional, sepse edhe në dy mandatet e kaluara kanë qenë vetëm 14 komisione.

Grupeve të mëdha parlamentare sipas asaj formule, pra sipas fuqisë politike, do t'u shtohet edhe nga një komision. Po e përsëris, na duhen 2/3 e votave për të ndryshuar numri.

I lus të gjithë deputetët që të kthehen në vendet e tyre. Dhe, të përdoret zilha nga regjia në mënyrë që të kthehen të gjithë. Do të presim dy-tre minuta derisa të kthehen deputetët që janë prapa.

Ju lus që të përgatiteni për votim për t'u ndryshuar Rregullorja e Kuvendit dhe për të ndryshuar numri nga 16 në 14 komisione.

Të pranishëm janë 103 deputetë. Ju lus të përgatiteni për votim.

Sqarim procedural: Miratimi i propozim-vendimit për formimin e 14 komisioneve parlamentare kërkon ndryshimin e nenit 69, paragrafët 3 dhe 4 të Rregullores së Kuvendit, me të cilin parashihen 16 komisione parlamentare.

Në bazë të nenit 81, paragrafi 3, të Rregullores së Kuvendit, ndryshimi miratohet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit. Pra, nevojiten së paku 80 vota për.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Ka edhe deputetë që votojnë me dorë. Kujt nuk i funksionon kartela? 59 deputetë votuan me elektronikë, 3 deputetë votuan me dorë, faktikisht 5 deputetë votuan me dorë.

Të nderuar deputetë,

Meqenëse votimi nuk është i vlefshëm, sepse nuk kanë marrë pjesë 80 deputetë, e mbyll këtë seancë dhe e ftoj mbledhjen e Kryesisë për të proceduar për këtë çështje, sot në orën 14:00, pastaj Kryesia do të vendosë për seancën e radhës. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani

KRYETARJA: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Vazhdojmë punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur sot.

Në sallë janë të pranishëm 89 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë dhe kemi kuorum të mjaftueshëm në përputhje me dakordin tonë në mbledhjen e Kryesisë. Fjalën ia kaloj për të propozuar se si të procedojmë deputetit Memli Krasniqi nga PDK-ja.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot në seancën e nisur paradite në diskutimet si deputetë të opozitës ne e theksuam domosdoshmërinë e respektimit të plotë të Rregullores së Kuvendit dhe nevojën e domosdoshme për kohezion politik, në mënyrë të Kuvendit t'i konstitujë trupat e vet punues, pra formimin e komisioneve parlamentare.

Pas shumë diskutimeve, kur u evidentuan edhe shkarjet nga Rregullorja dhe pas dështimit të votimit pa arritur pajtueshmëri politike, ne në mbledhjen e sotme të Kryesisë i shprehëm vërejtjet tona, i diskutuam, dhe pasi arritëm një dakordim kemi pajtim të plotë për rrugën që duam ta ndjekim së bashku për të mundur votimin e suksesshëm të komisioneve parlamentare dhe bazuar në këtë dakordim paraprakisht kemi nevojë që ta ndryshojmë rendin e ditës, duke e shtuar një pikë të re para votimit të përbërjes së komisioneve parlamentare dhe propozoj që pika që duhet votohet proceduralisht me 2/3 e deputetëve të pranishëm të jetë - vazhdimi i vlefshmërisë së Rregullores së Kuvendit edhe për Legjislaturën e shtatë.

Meqenëse ne pak a shumë e dakorduam idenë dhe vendimin apo draft propozimin-vendimin për këtë çështje dhe në mungesë të materialeve të shkruara për deputetët, ky vendim, nëse votohet bëhet vendim, duhet ta ketë vetëm një pikë që po e lexoj:

Konfirmohet vlefshmëria e Rregullores së Kuvendit edhe për Legjislaturën e shtatë deri në miratimin e Rregullores së re të Kuvendit, me përjashtim të nenit 69, paragrafi 4.

Për ta shpjeguar, paragrafi 4 i nenit 69 i parasheh komisionet funksionale dhe meqenëse propozimi që ka qenë i paraparë për rendin e sotëm të ditës e parasheh një numër prej 10 komisioneve me emërtime të reja, ne i japim validitet Rregullores së Kuvendit edhe për Legjislaturën, anëtarë e deputetë të së cilës jemi, deri në miratimin potencial të një Rregulloreje të re, por lëmë hapësirë që pas miratimit të këtij vendimi, një vendim tjetër për komisionet të krijojë mundësinë pra që 14 komisione të konstituohen menjëherë pas marrjes së këtij vendimi.

Andaj, besoj që dakordimi ekziston, por formalisht kërkoj që të gjithë deputetët ta mbështetin këtë propozim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kërkoj nga grupet parlamentare që të deklarojnë lidhur me këtë propozim. Zoti Selimi nga Lëvizja Vetëvendosje.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zonja kryetare!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje mbështet propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së për vazhdimin e vlefshmërisë së Rregullores së Punës së Kuvendit. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Gashi nga LDK!

ARBEN GASHI: Faleminderit! Në bazë të dakordimit në mbledhje të Kryesisë së bashku edhe me partitë opozitare, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e konfirmon marrëveshjen dhe e përkrah. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! A dëshironi të deklarojeni nga PDK, atëherë Grupi Parlamentar i AAK-së, Teuta Haxhiu e ka kërkuar fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Edhe Aleanca dakordohet me propozimin e Memli Krasniqit të PDK-së.

KRYETARJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma, zoti Shala.

HAXHI SHALA: Edhe ne si Grup jemi dakord me propozimin e zotit Krasniqi, kështu që e mbështetim këtë propozim.

KRYETARJA: Faleminderit! Zoti Kinolli, nga Grupi 6+.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

Siç u dakorduar në mbledhjen e Kryesisë, edhe ne e përkrahim dhe e mbështetim propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së, përkatësisht shefit të PDK-së, Memli Krasniqi. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! A dëshiron fjalën Grupi Parlamentar i Listës serbe. Zoti Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: U skladu sa dogovorom na Predsedništvu, podržaćemo ovaj predlog. Hvala!

KRYETARJA: Faleminderit! Pra, propozimi është që ta ndryshojmë rendin e ditës që nënkupton që duhet t'i kemi 2/3 e deputetëve të pranishëm pro këtij propozimi. A ka nevojë që ta lexoj edhe një herë propozimin e zotit Krasniqi, apo e keni të gjithë të qartë? Një herë pra votohet vetëm për rendin e ditës, që të shtohet kjo pikë, rrjedhimisht i kemi 94 deputetë në sallë, pra 2/3 e këtij numri duhet të votojnë për, në mënyrë që kjo pikë të futet në rend të ditës.

Regjia dhe deputetët përgatituni për votim. Votojmë tash!

A ka vota edhe me dorë? E lus Administratën që t'i numërojë! Atëherë, 84 kanë votuar nëpërmjet pajisjeve elektronike, 9 deputetë kanë votuar me dorë, rrjedhimisht 93 deputetë kanë votuar pro propozimit, supozoj që edhe nga votimi me dorë ishin të gjithë pro deputetët. Faleminderit!

Nuk ka vota kundër dhe as abstenim, rrjedhimisht ndryshohet rendi i ditës për të futur pikën e propozuar nga zoti Krasniqi në dakordim të plotë të anëtarëve të Kryesisë dhe shefave të grupeve parlamentare.

Kjo nënkupton që e kemi një pikë të re të rendit të ditës, pra që të vazhdohet validiteti i Rregullores së deritanishme të Kuvendit me përjashtim të nenit 69, pika 4 e Rregullores. Për këtë pikë të rendit të ditës duhet t'i kemi 80 vota për, por paraprakisht, fjalën e ka kërkuar zoti Krasniqi. Urdhëroni!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zonja kryetare!

Unë vetëm për procedurë formale, meqenëse u ndryshua rendi i ditës. Si propozues besoj më duhet formalisht ta lexoj edhe një herë para votimit tekstin e propozim-vendimit.

Pra, po e përsëris, propozim i vendimit është vetëm një pikë dhe ajo thotë: “Konfirmohet vlefshmëria e Rregullores së Kuvendit edhe për Legjislaturën e shtatë deri në miratimin e Rregullores së re të Kuvendit, me përjashtim të nenit 69, paragrafi 4”. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! A ka nevojë të deklarohen shefat e grupeve? Meqenëse, tashmë edhe e keni shprehur pajtimin në mbledhje të Kryesisë dhe sa po shoh nuk ka interesim, atëherë e vendos në votim këtë pikë të rendit të ditës:

1. Vlefshmëria e Rregullores së Kuvendit deri në nxjerrjen e Rregullores së re, me përjashtim të nenit 69, pika 4

Pra, konfirmohet vlefshmëria e Rregullores së Kuvendit deri në nxjerrjen e Rregullores së re, me përjashtim të nenit 69, pika 4.

Përgatituni për votim. Për këtë pikë të rendit të ditës na duhen së paku 80 vota për. Regjia dhe deputetët bëhuni gati për votim. Votojmë tash!

I kemi 85 vota për, me pajisje elektronike. Sa vota i kemi me dorë, ju lutem Administrata? Atëherë, totali i votave për është 91.

Rrjedhimisht, kalon edhe kjo pikë e rendit të ditës me 2/3-at e të gjithë deputetëve, ashtu siç kërkohet. Konstatoj se Legjislatura e shtatë e Kuvendit e njeh Rregulloren e Kuvendit të vitit 2010 me ndryshimin e nenit 69, paragrafin 4 dhe po ashtu numrin e komisioneve në katërmëdhjetë, ashtu siç kishte dakordim.

Në qoftë se ka nevojë diskutime për këtë temë, në rregull. Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit dhe i falënderoj të gjithë deputetët për mbështetjen e propozimit dhe votimin unanimitet.

Meqenëse tash në njëfarë forme jemi shmangur prej nenit 69, paragrafi 4, ne në radhë e kemi votimin e propozim-vendimit që është sjellë si pikë e rregullt e seancës dhe ai propozim parasheh dhjetë komisione funksionale. Katër janë të parapara si të përhershme, neni 69, pika 3, dhe ma merr mendja që krejt çfarë ka mbetur është ta votojmë propozim-vendimin e komisioneve që e keni sjellë më herët, ndoshta me propozimin që ka qenë për ta shtuar te emërtimi i Komisionit për Qeverisje Lokale dhe Media dhe Administratën Publike, siç jemi dakorduar të gjithë. Faleminderit!

E kemi edhe një ndryshim. Realisht, te Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ne kemi pasur një dakordim në mënyrë që t'ua mundësojmë të gjitha komuniteteve etnike në Kosovë që të përfaqësohen në këtë komision, siç e parasheh edhe Kushtetuta. Për ta arritur këtë duhet të shtohet numri prej 12 në 18, meqenëse ai komision funksionon me 1/3-tën përfaqësues të komuniteteve, 1/3-tën përfaqësues të komunitetit serb dhe 1/3-tën përfaqësues të komunitetit shqiptar dhe për ta arritur përfaqësimin e të gjitha komuniteteve joshqiptare dhe joserbe u dakorduar që të jetë numri 18.

Pra, propozim-vendimi duhet të plotësohet me këtë, që 18 anëtarë të jenë në Komisionin për Komunitete dhe që Komisionit për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media fillimisht t'i shtohet Administrata Publike. Faleminderit!

2. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

KRYETARJA: Faleminderit, z. Krasniqi!

Edhe me sqarimin nga Administrata, tash meqenëse jemi shmangur nga neni 69, pika 4, rrjedhimisht edhe numri i komisioneve dhe të gjitha çështjet që i përmendët ju kalojnë me shumicë të thjeshtë. Pra, po e konfirmoj që kemi dakordim të të gjitha grupeve parlamentare në Kryesinë e Kuvendit që Komisionit për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media t'i shtohet Administrata Publike. Ndërsa kjo hiqet nga kjo fushëveprimtaria e paraparë në Komisionin për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe po ashtu që ka dakordim që Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve të plotësohet me numrin e anëtarëve, nga 12 sa ishte propozuar në 18 anëtarë, duke u bazuar edhe në praktikat e mëhershme, në mënyrë që të gjitha komunitetet të kenë përfaqësues të tyre në këtë komision.

Ftohen kryetarët e grupeve parlamentare dhe përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë që t'i propozojnë deputetët për plotësimin e pozitave të shtuara në Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Ose në qoftë se keni për të deklaruar diçka si kryetarë të grupeve parlamentare lidhur me këtë çështje të tretë?

Më lejoni ta sqaroj edhe një gjë, që me rastin e votimit të përbërjes së komisioneve parlamentare, emrat e deputetëve që akoma nuk e kanë dhënë betimin, në seancën e sotme nuk votohen. Pra, do të votohen vetëm emrat e deputetëve aktualë. Në qoftë se nuk i kemi propozimet tani, atëherë do t'i marrim në ndërkohë.

Vazhdojmë! Urdhëroni z. Selimi, e keni fjalën.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, znj. kryetare!

E kemi një propozim për ndryshim në propozimin tonë të mëhershëm që e kemi dërguar për emrat e deputetëve pjesëmarrës në komisione parlamentare. Bëhet fjalë për Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Kërkojmë zëvendësimin e Hajrulla Çekut me deputetin Elbert Krasniqi. Lus të procedohet kjo në procesverbal dhe pastaj ne t'i kryejmë procedurat nëse ka nevojë.

Ndërsa sa i përket plotësimit të vendeve të tjera, i bëjmë më vonë.

KRYETARJA: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar z. Haradinaj, nga AAK-ja.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Meqenëse tash veç jemi dakorduar për emrat e përveçëm, unë kisha dëshiruar t'i lexoj, ose sido që ta vlerësoni. Më mirë po i lexoj.

Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë, kryetar deputetja Time Kadriaj.

Komisioni për Integrim Evropian, anëtar, mbetet i hapur, por do ta shohim, mund të lëvizet, por për momentin është Bekë Berisha.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Donika Kadaj, anëtare.

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, deputetja Teuta Haxhiu.

Komisioni për Buxhet dhe Transfere, deputeti Shkumbin Demaliaj.

Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, dhe Administratë Publike tash, Rasim Selmanaj, anëtar.

Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, Pal Lekaj, anëtar.

Komisioni për Siguri dhe Mbrojtje, Bekë Berisha, nënkryetar.

Komisioni për Shëndetësi dhe Punë e Mirëqenie Sociale, Albena Reshitaj, kryetare.

i Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis, Rasim Selmanaj, anëtar.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve, Rasim Selmanaj.

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione, Teuta Haxhiu, anëtare.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Ali Berisha, anëtar.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Gazmend Sylaj, anëtar.

Këta ishin emrat të cilët ne i propozojmë. Natyrisht se i kemi edhe dy raste, por që do të presim edhe emërimin e ri të deputetit Abrashi, e pastaj e kompletojmë. Të gjitha këto materiale jua dorëzoj edhe me shkrim sa më shpejt që të jetë e mundur. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti Haradinaj! Fjalën e ka kërkuar, kryetari i Grupit Parlamentar të Listës serbe, zoti Simiq.

IGOR SIMIĆ: Hvala predsednice!

Dakle pošto smo proširili broj članova u Odboru za prava i interesa zajednica i porvatak, u ime Poslaničke grupe Srpska lista predlažemo da se pored postojeća četiri člana dodaju i gospodin Miloš Perović i gospodin Ljubinko Karadžić u ime Srpske zajednice. Hvala!

KRYETARJA: Faleminderit! Nga Nisma-AKR, zoti Shala e ka kërkuar fjalën.

HAXHI SHALA: Po, kryetare!

E kemi një gabim teknik nga Administrata. Në vend të Albulena Balaj-Halimi, si kryetare e Grupit Parlamentar të Komisionit për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike vihet emri i Endrit Shalës.

E kemi dërguar edhe me shkrim në Administratë, por më mirë ta citojmë prapë. Faleminderit!

KRYETARJ: Faleminderit! Është bërë ky përmirësim në ndërkohë, me kërkesën tuaj. Fjalën e ka kërkuar edhe Veton Berisha. Deputeti Berisha, urdhëroni!

VETON BERISHA: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Më lejoni që ta falënderoj Kryesinë që e ka marrë për bazë kërkesën time të paradites, domethënë pjesën time të paradites, për përfshirjen e të gjitha komuniteteve në komisionin e përhershëm. Është shumë e rëndësishme që ne të jemi aty, pavarësisht pozicioneve tona se ku gjendemi.

E keni të deponuar edhe me shkrim, domethënë flas në emër të tre deputetëve të pavarur tani, timin Veton Berisha, Etem Arifi dhe Duda Balje, se do të jemi pjesë e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Po më vjen mirë që edhe zoti Elbert Krasniqi tash veç e ka kuptuar që është mirë të jetë në këtë komision, sepse për atë edhe jemi të thirrur që të dytë të jemi në këtë komision, sepse i mbrojmë këto të drejta. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, zoti deputet! E mirëpresim kontributin tuaj në të gjitha komisionet dhe natyrisht duke e marrë parasysh propozimin që e dhatë, jemi dakorduar që të gjithë.

Nuk ka deputetë të tjerë të paraqitur. Atëherë, e vendos në votim numrin e komisioneve 14 në përbërjen e propozuar nga grupet parlamentare, përveç emrave që do të plotësohen në ndërkohë, me korrigjimet që u bënë këtu në seancë. Me ndryshimin e emrit të Komisionit për Qeverisje Lokale, duke përfshirë edhe Administratën Publike, dhe po ashtu numrin e deputetëve të Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Regjia dhe deputetët, përgatituni për votim. Votojmë tash!

A ka deputetë pa kartelë që dëshirojnë të votojnë?

E lus Administratën që t'i numërojë.

Atëherë, me 90 vota për, asnjë kundër dhe 1 abstenim, kalon edhe propozim-vendimi për themelimin dhe funksionalizimin e komisioneve parlamentare sipas propozimit të Kryesisë dhe propozimeve që i dëgjuam këtu në seancë.

Ju falënderoj shumë të gjithëve për punën dhe kontributin në seancën e sotme dhe shihemi në seancën e radhës!

E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë